

GJENDJA E KLASËS PUNËTORE NË SHQIPËRI (I)

GJENDJA E KLASËS PUNËTORE NË SHQIPËRI (I)

Tiranë, Janar 2016



ISBN 978-9928-178-07-7



GJENDJA E KLASËS PUNËTORE NË SHQIPËRI (I)

Përgatitur nga “Instituti për Kritikë dhe Emancipim Shoqëror” me

mbështetjen e “Rosa Luxemburg Stiftung Southeast Europe”

me fonde të “German Federal Foreign Office”

Tiranë, Janar 2016



Grupi i punës:

Mirela Ruko, koordinatore e projektit.

Syzana Kurtallari, hulumtuese e literaturës.

Matilda Miftiu, intervistuese dhe analizuese e të dhënave.

Xhuliano Bregasi, intervistues dhe analizues i të dhënave.

Alfred Bushi, redaktor i studimit.

Arlind Qori, redaktor i studimit.

Foto: Ole Elfenkämper

PËRMBAJTA

PARATHËNIE	5
I. HYRJE KONCEPTUALE	6
II. METODOLOGJIA	9
III. RISTRUKTURIMI NEOLIBERAL I SHOQËRISË SHQIPTARE	10
IV. LEGJISLACIONI PËR TË DREJTAT E PUNËTORËVE	17
V. INTERVISTAT	18
5.1. Kushtet e punës dhe respektimi i të drejtave punëtore	18
1. Sa orë në ditë punoni?	18
2. A punoni orë shtesë? A paguhen ato?	19
3. Sa ditë pushimi keni në javë?	20
4. A jeni aksidentuar ndonjëherë? Pas aksidentit, a janë marrë masa nga pronari për parandalimin e rreziqeve?	21
5. A keni kontratë pune? – Individuale apo kolektive – me kohë të pjesshme apo të plotë?	23
6. A ju paguhen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore? A respektohet kontrata?	27
7. A jeni i kënaqur me punën që bëni?	29
5.2. Marrëdhëniet klasore brenda vendit të punës	31
1. A ushtron presion punëdhënësi/mbikëqyrësi gjatë orarit të punës?	31
2. A ju ka bërë presion (pronari) për të mos u organizuar në sindikata?	32
5.3. Kushtet e jetesës dhe gjendja ekonomike	33
1. Gjendja ekonomike: të dhëna të përgjithshme	33
2. Gjendja ekonomike: të dhëna gjinore	39
3. Gjendja ekonomike: sipas sektorëve të punësimit	41
5.4. Ndërgjegjja klasore e punëtorëve	43
1. A e dini se ekziston Kodi i Punës?	43
2. A mendoni se po shfrytëzoheni në punë?	45
3. Çfarë do të doje të ndryshoje në punën që bën?	47
4. A mendoni se punëtorët mund ta marrin vetë drejtimin e vendit të punës pa pronarin?	48
5. Keni punuar para vitit 1990? - Nëse po, a ishin më mirë apo më keq?	48
VI. PËRFUNDIME PARAPRAKE	50



Ole Elfenkämper, Bulqizë 2012

PARATHËNIE

Arsyeja kryesore e themelimit të Institutit për Kritikë dhe Emancipim Shoqëror ka qenë hulumtimi kritik i fenomeneve shoqërore për të thyer hegjemoninë kulturore të elitave ekonomike e politike shqiptare të njëzetepesë viteve të fundit. Shqipëria gëlon nga problemet e thella të shumë grupeve shoqërore të marginalizuara, mirëpo, në këndvështrimin tonë, gjendja e punëtorisë si klasë dhe kauza e të drejtave të tyre është nga më të heshtuarat. Ndaj studimi ynë i parë ka pasur për qëllim kuptimin e kushteve të punës dhe gjendjes ekonomike të punëtorisë, duke hapur një fushë të re dhe të rëndësishme studimesh shoqërore në Shqipëri.

E mëposhtmjia është vetëm pjesa e parë e studimit, i cili do të pasurohet me të dhëna dhe qasje interpretuese në pjesën e dytë, puna për të cilën do të zhvillohet gjatë këtij viti.

Ky studim do të mbetet ide abstrakte po të mos merrte mbështetjen financiare të Fondacionit Rosa Luxemburg (Rosa Luxemburg Stiftung), i cili meriton gjithë konsideratën dhe mirënjohjen tonë.

I. HYRJE KONCEPTUALE

Titulli i këtij punimi evokon të famshmen “Gjendje të klasës punëtore në Angli”, të shkruar nga Fridrih Engelsi i ri më 1845. Shumëçka ka ndryshuar gjatë shtrirjes dhe zhvillimit të kapitalizmit në këta 171 vjet, mirëpo jo shfrytëzimi i punëtorëve. Madje në vende të periferisë së sistemit-botë kapitalist si Shqipëria trajtat dhe intensiteti i shfrytëzimit u afrohen fabrikave të Mançesterit, në një kthim pervers historie.

Situata politiko-shoqërore shqiptare e njëzetepesë viteve të fundit ka fshirë ideologjikisht nga ligjërimi publik jo vetëm punëtorët si klasë, por dalëngadalë edhe punëtorin si emër të veçueshëm në mizërinë e identiteteve shoqërore. Shqetësimi ynë i kahershëm teorik e politik mund të shprehet me një pyetje: Çfarë e mundëson zhdukjen ideologjike të emrit të punëtorit/ëve dhe kauzës punëtore? Nënpyetje: Si është e mundur që të drejtat dhe interesat e sa e sa grupeve shoqërore artikulojnë, diku fort e diku më dobët, kurse ato punëtore janë fshirë krejt? Pse vëmendja publike është më e ndjeshme ndaj fatit të një specieje të rrallë qukapiku sesa ndaj atij të një klase njerëzish nga më të rëndësishmet në shoqëri? Pyetjet e mësipërme mund të merrnin edhe karakter retorik, mirëpo ky nuk është manifest, por orvatje studimore për të kuptuar, ndër të tjera, edhe reduktimin në hiç të punëtorëve.

Një nga efektet e këtij heshtimi është se zëri i punëtorëve nuk ndihet thuajse fare në ligjërimin publik. Edhe ato pak raste kur interesat e tyre artikulojnë, ata flasin nëpërmjet “përfaqësuesve” të tyre sindikalë, të organizuar në forma burokratike e korruptive, çka reflektohet edhe në masën e papërfillshme të punëtorëve të regjistruar në to. Ndaj synimi kryesor i këtij punimi ka qenë dhënia zë punëtorëve të cilët, përmes intervistave të strukturuar sipas kërkesave të kritikës së ideologjisë, kanë artikulluar problemet kryesore në vendin e punës dhe rreth mënyrës së jetesës: marrëdhëniet pushtetore me pronarin¹, me mjetet e prodhimit dhe bashkëpunëtorët, rreziku në punë, tjetërsimi, e më tej, mjaftueshmëria e pagës, jeta dhe botëkuptimi shoqëror etj.

Pse ka rëndësi që punëtorët të evidentohen si klasë shoqërore? Fillimisht duhet thënë se në mënyrë formale njerëzit mund të ndahen në shumë kategori me rëndësi shoqërore: gjinore, kombëtare, krahinore, estetike, politike etj. Shpërndarja e njerëzve në klasa mbështetet në kriterin e raportit me mjetet e prodhimit. Ky raport, megjithëse është më së shumti ekonomik, ka edhe dimensione politike e ideologjike. Punimi ynë bazohet teorikisht në parimin se ndarja klasore është forma më e rëndësishme e identitetit shoqëror për nga efektet që prodhon në të tërën shoqërore – aktualisht dhe historikisht – dhe në përthyerjen që marrin ndarjet e tjera shoqërore si pasojë e kontradiktave klasore. Nëse mund të mendojmë se ndarjet kombëtare nuk kanë medoemos efekt në ndarjet gjinore apo estetike, se asnjëra prej tyre nuk ka pse të prodhojë efekte të njëra-tjetra, ndarjet klasore, drejtpërdrejt apo tërthorazi, ndikojnë në të gjitha ndarjet e tjera shoqërore. Kështu, të qenit grua është produkt edhe i ndarjes shoqërore të punës, të qenit shqiptar rezultat i ndarjes ndërkombëtare të punës, të qenit nga një krahinë apo një tjetër i diferencimeve në lloje pune dhe shpërblym brenda një vendi etj.

Po e nisim nga ndarja e parë dhe më e thjeshtë: disa njerëz janë pronarë të mjeteve të prodhimit, të tjerët jo. Zakonisht të parët janë shumë më të pakët në numër se të dytët. Në kapitalizëm, të parët (pronarët) kanë

¹ Në këtë studim termat “pronar” dhe “punëdhënës” do të përdoren në mënyrë ndërkëmbyese. Megjithëse gjykojmë se përdorimi i termit “punëdhënës” ka karakter ideologjik pasi fsheh pabarazinë e skajshme në marrëdhëniet e punës duke i konsideruar palët si të barabarta (punëdhënës-punëmarrës), na është dashur ta përdorim si gjatë intervistave, ashtu edhe në analizë për shkak se është termi që në legjislacionin e punës shënjon pronarin.

mundësi dhe interes të blejnë fuqinë punëtorë të të dytëve (jopronarëve), të cilët, në pamundësi për të nxjerrë jetesën ndryshe, kthehen në punëtorë.

Mirëpo ndarja klasore nuk mund të bazohet vetëm në dihotominë pronarë/jopronarë mjetesh prodhimi. Jo të gjithë pronarët kanë mundësi të blejnë fuqinë punëtorëve të të tjerëve. Kësisoj ata nuk mund të jenë kapitalistë, por të vetëpunësuar, çka përfshin edhe kategoritë e biznesit të vogël familjar. Madje ka pronarë mjetesh prodhimi, sidomos të tokës bujqësore apo trojeve të ndërtimit, të cilët nuk investojnë kapitale në to, por përfitojnë rentë nga investuesit e kapitaleve. Po ashtu jo të gjithë jopronarët e mjeteve të prodhimit mund të quhen punëtorë në kuptimin klasor të fjalës, pavarësisht se shesin fuqinë e tyre punëtore. Bie fjala, a mund të përfshihet në klasën punëtore një njeri fuqia punëtore e të cilit shitet në shifra stratosferike, si p.sh. Cristiano Ronaldo-ja? A mjafton fakti që ai nuk është aksionar i Realit të Madridit, por e shet fuqinë e tij punëtore tek aksionarët për ta renditur atë në një klasë me minatorët, metalurgët apo punëtorët e fasonerive? Teoricienë të rëndësishëm klasorë si Nicos Poulantzas-i i përjashtojnë ata nga klasa punëtore duke përdorur për bazë të ardhurat e tyre të larta, lehtësisht të transformueshme në kapitale, edhe në formë aksionesh. Kësisoj në terma të ardhurash, në klasën punëtore do të renditen vetëm ata punonjës me pagë të ardhurat e të cilëve e pamundësojnë kursimin e mjaftueshëm për t'i kthyer në investitorë ose aksionarë kapitalistë.²

Nga ana tjetër, klasa punëtore në kapitalizëm nuk karakterizohet vetëm nga mungesa e pronësisë mbi mjetet e prodhimit, por edhe nga ajo e zotërimit të tyre. Në rendet shoqërore parakapitaliste, kryerësi i punës mund të mos ishte pronar i tokës apo i mjeteve të punës, por prapëseprapë i zotëronte ato, në kuptimin se e drejta zakonore ia pamundësonte pronarit ta dëbonte apo t'i impononte vullnetin e vet përtej barrës së haraçit. Në kapitalizëm, punëtorët e humbin zotërimin e mjeteve të prodhimit pasi pronari i këtyre të fundit bëhet edhe organizues i punës, kontrollues dhe mbikëqyrës i intensitetit dhe cilësisë së saj. Me rritjen e organizimit kapitalist të ndërmarrjeve, pronari rresht se pasuri funksione të drejtpërdrejta mbikëqyrëse dhe organizuese, çka i lihet si detyrë një klase të re, as pronare, as punëtore. Autorë të ndryshëm e kanë quajtur mikroborgjezi e re (Nicos Poulantzas), ose ia kanë hequr mëvetësinë klasore duke i renditur në pozicione klasore kontradiktore (Erik Olin Wright). Sidoqoftë, në klasën punëtore nuk mund të përfshihen ata punonjës me rrogë puna dhe funksioni i të cilëve është të organizojnë, drejtojnë dhe mbikëqyrin punën prodhuese të të tjerëve.

Përtej sferës së prodhimit, por lidhur ngushtë me të, punëtorët janë të përjashtuar përmbajtësisht dhe ndonjëherë edhe formalisht nga aparatet e pushtetit politik dhe ato ideologjike. Jo se nuk kanë të drejtë vote si dikur, por se këtë të drejtë, në pamundësinë strukturore për t'u organizuar dhe artikuluar politikisht, nuk e përdorin si punëtorë, por si bartës të identiteteve të tjera shoqërore, gati edhe mikroskopike si fisi e familja. Për sa i përket prodhimit të përfytyrimeve, botëkuptimeve dhe vlerave ideologjike, punëtorët si klasë jo vetëm janë fare të pandikimtë në të (të përjashtuar nga drejtimi dhe pjesërisht edhe nga pjesëmarrja në aparate të tilla ideologjike si media, shkolla, institucionet kulturore, fetare etj.), por, siç e cekëm edhe më lart, problemet dhe

² Në teorinë shoqërore marksiste për më se një shekull është zhvilluar një debat kompleks mbi lidhjen e identitetit klasor punëtor me llojin e punës. Teza që ka dominuar është se punëtorë (ndryshe nga punonjësit) quhen vetëm ata puna e të cilëve prodhon mbivlerë, pra u nënshtrohet drejtpërdrejt marrëdhënieve dhe logjikës kapitaliste të prodhimit. Prej shekullit XIX deri në vitet '70 të shekullit XX ka pasur hegjemoni mendimi se vetëm puna fizike (e kualifikuar ose jo) dhe prodhimi industrial meritojnë statusin e punës produktive – për pasojë klasa e mirëfilltë punëtore reduktohej te këta punëtorët e këtyre degëve të ekonomisë. Mirëpo në dekadat e fundit, me rritjen e sektorëve të prodhimit jomaterial dhe intelektual, po fiton gjithnjë e më shumë terren se punë produktive mund të quhet edhe puna intelektuale me kushtin që punëtorët intelektualë të jenë të nënshtuar ndaj pronarit dhe mbikëqyrësve në vendin e punës dhe paga e tyre të mos u mundësojë investime kapitale serioze.

kauza e tyre janë të papërfillshme për këto aparate të cilat prodhojnë shumëçka për të mos prodhuar asgjë kritike klasore.

Mirëpo çështja e marrëdhënies me mjetet e prodhimit dhe aparatet politiko-ideologjike ndërlikohet nëse marrim në konsideratë edhe kategorinë e të papunëve. I papunë konsiderohet kushdo që nuk është pronar mjetesh prodhimi, nuk është përfitues rente apo zotërues pasurish që do t'i mundësonin të jetonte pa punuar. Si i tillë, i papuni kërkon punë dhe nuk gjen, ose gjen rrallë, me ditë të caktuara në muaj. Si punëtorë potencialë, të papunët do të duhej të përfshiheshin në klasën punëtore jo vetëm kur gjejnë punë.³ Mirëpo raporti i tyre me kapitalizmin nuk është ai i shfrytëzimit (prodhim mbivlere), por i përjashtimit nga plotësimi i nevojës dhe të drejtës për të punuar. Edhe më shumë se ata që gjenden në marrëdhënie pune, të papunët janë të pandikimtë në vendimmarrjen politike. Mosmarrja e pagës dhe mungesa e garancive sociale si rroga e qytetarisë apo ndihma ekonomike e mjaftueshme e tjetërsojnë edhe të drejtën minimale politike që gëzojnë, atë të votës. Në vende si Shqipëria ata janë shënjestra kryesore e blerjes së votës nga partitë kryesore politike. Si të tillë, ndaj tyre ngrihet një përçmim moralizues ideologjik që i zhyt edhe më poshtë punëtorëve në përfilljen publike. Sidoqoftë, argumenti kryesor i përjashtimit të tyre nga radhët e klasës punëtore ka të bëjë me potencialet e organizimit. Të papunët mund të jenë edhe më të shumtë në numër se punëtorët, por jeta sociale e tyre është e palidhur me të tjerët si vetja. Me ta nuk ndajnë vuajtjet e përditshme të shfrytëzimit në të njëjtin vend pune. I vetmi rast kontakti i domosdoshëm me të tjerë si vetja është radha për marrjen e pagesës së papunësisë në zyrat shtetërore. Mirëpo ky kontakt rudimentar pamundëson çfarëdo potenciali vetorganizimi për kërkimin e të drejtës për punë.⁴ Sidoqoftë, ky punim nuk synon t'i kapërcejë caqet e veta modeste teorike për t'i dhënë përgjigje pyetjes nëse të papunët bëjnë pjesë në klasën punëtore. Duke u shtuar konsideratave të mësipërme vështirësitë hulumtuese konkrete të realitetit shoqëror shqiptar, të papunët nuk do t'i konsiderojmë si pjesë të klasës punëtore shqiptare.

Pas këtyre saktësimeve teorike, lind pyetja se si mund të përdoret nocioni i klasës për punëtorinë shqiptare. Siç do ta trajtojmë imtësisht më poshtë, Shqipëria e njëzetepesë viteve të fundit ka pësuar një proces të pandalshëm çindustrializimi, duke e reduktuar numerikisht klasën punëtore tradicionale dhe, në përgjithësi, shpërbërë format e organizimit dhe vetëdijes politike punëtore. Mirëpo nuk mund të ketë marrëdhënie shoqërore kapitaliste pa klasë punëtore. Në rastin shqiptar, pavarësisht deklasimit punëtor në forma ekzistence

³ Nëse përdorimin konceptin e Erik Olin Wright-it mbi rëndësinë e trajektoreve sociale në përcaktimin e identitetit klasor, atëherë të papunët do të renditeshin në klasën punëtore. Trajektorja klasore nënkupton pritshmëritë objektive të punësimit në të ardhmen. Kështu fëmijët e një familjeje punëtore mund të futen brenda klasës punëtore përderisa, sidomos në vende me mobilitet të ulët klasor, pritshmëritë objektive të punësimit të tyre kanë të bëjnë me pozicione pune që i përkasin klasës punëtore. Sipas të njëjtës logjikë, të papunët do të renditeshin edhe më kollaj brenda klasës punëtore pasi të gjeturit të një vendi pune që i takon klasës punëtore përbën synimin e tyre imediat. Për më tepër, shih: Wright, Erik Olin. (1979). *Class, crisis and the state*. London: Verso, f. 97

⁴ Philippe Van Parijs- i jep këtë shpjegim pyetjes nëse të papunët përbëjnë klasë më vete: "Edhe pse të papunët janë klasë në kuptimin objektiv, shumëkush argumenton se ata nuk do të bëhen kurrë klasë në kuptimin subjektiv; pra, ata nuk do të fitojnë asnjëherë ndërgjegje klasore apo organizojnë aksion klasor. Të papunët dhe punëtorët rastësorë formojnë një grup heterogjen, të cilit nuk janë të ndërgjegjshëm se i përkasin, lere më pastaj të jenë krenarë për të. Radhët e asistencës sociale, ndryshe nga fabrikat, nuk prodhojnë atë lloj ndërveprimi që mund të çojë në kërkesa dhe aksione kolektive. Ndryshe nga punëtorët, të cilët mund të hidhen në grevë, të papunët nuk kanë armë të përdorshme për të mbështetur pretendimet e tyre. Ata mes tyre që janë të aftë për t'i organizuar dhe mobilizuar të tjerët, janë boll 'të aftë' për të gjetur një punë të vërtetë dhe për ta braktisur klasën." - Wright, Erik Olin. (1989). *The Debate on Classes*. London: Verso, f. 237

shoqërore plebejase (papunësi, jetesë nga remitancat, përkujdesje fisnore ose shtetërore), klasa punëtore vazhdon të ekzistojë. Për lehtësi studimi, e kemi ngushtuar trajtimin e klasës punëtore në ata sektorë ku intensiteti i ekzistencës së saj është më i fortë dhe i dukshëm. Për të shmangur format e vetëpunësimit, punësimit familjar apo fisnor, punësimit në ndërmarrje të vogla etj., kemi zgjedhur të trajtojmë punëtorët e ndërmarrjeve të mëdha dhe me rëndësi kyçe në jetën ekonomike të vendit: miniera, fasoneri, industri ushqimore, ndërtim dhe *call center*-a. Arsyeja tjetër është politike. Mundësia e lindjes së ndërgjegjes shoqërore dhe politike punëtore është më e madhe aty ku punohet shumë vetë bashkë, ku solidariteti si horizont i shtrirë përtej vetes apo të afërmit fisnor është më real.

II. METODOLOGJIA

Shtegu metodologjik i ndjekur ka pasur për synim të kuptojë jo vetëm gjendjen e klasës punëtore në Shqipëri, por edhe t'u japë zë punëtorëve duke sfiduar heshtimin ideologjik. Për pasojë, kompleksiteti i çështjes ka shtruar nevojën e kompleksitetit metodologjik. Do të kishte qenë më e lehtë të përdornim metodën sasiore poperiane të formulimit të një hipoteze, nxjerrjes së implikimeve dhe matjes së indikatorëve për ta testuar të parën. Mirëpo rigoroziteti sasiorist do të linte të pazbulueshme dhe të pahulumtueshme aspekte të rëndësishme të gjendjes së klasës punëtore dhe, mbi të gjitha, do ta reduktonte në numra dëshminë e kushteve të punës dhe të jetesës së tyre. Prandaj punëtorët janë marrë në intervista të cilat kanë kombinuar pyetjet sasiore me përgjigje të mbyllura dhe ato cilësore, ku u është dhënë përparësi spontanitetit dhe pakufizueshmërisë së përgjigjeve të tyre. Kësisoj, analiza e të dhënave sasiore (marrëdhëniet, krahasimet etj.) është kombinuar me interpretimin e përgjigjeve të hapura, kjo e fundit në kuadrin e një hermeneutike kritike të teksteve. Sipas parimeve të kritikës së ideologjisë, e vërteta nuk është konsideruar thjesht në kuadrin "objektiv" e "të paanshëm" të të dhënave që flasin vetë, por, mbi të gjitha, në atë të theksimit të karakterit subversiv dhe çështues të zërave që e çajnë koren ideologjike. Prandaj edhe përgjithësimet sasiore janë shtratzuar në domosdoshmëritë e nxjerrjes në pah të kontradiktave shoqërore dhe qorrsokakëve të ideologjisë si ligjërime politiko-shoqërore sundues, heshtues dhe përjashtues.

Pyetjet janë ndarë në tre blloqe të mëdha: mbi kushtet e jetesës, kushtet e punës dhe botëkuptimin e punëtorëve. Te kushtet e jetesës synimi ka qenë të matet dhe kuptohet përballueshmëria e jetesës nga paga, raporti i kësaj të fundit me të ardhurat familjare apo me forma të tjera të ardhurash që nuk burojnë nga puna, ajo se çfarë u mundëson familjeve punëtore marrja e një page, nëse mund të përmbushin të drejtat formale të arsimimit të fëmijëve të tyre etj. Për sa u përket kushteve të punës, nënçështjet kryesore kanë të bëjnë me rrezikun shëndetësor në punë, raportet pushtetore me pronarin dhe mbikëqyrësit, marrëdhëniet midis punëtorëve dhe vështirësitë e organizimit sindikal, njohjen dhe zbatimin e të drejtave që burojnë nga kuadri ligjor etj. Kurse aspekti botëkuptimor është kufizuar në njohjen e ndërgjegjes punëtore mbi koncepte si shfrytëzimi në punë, barazia, mundësia e vetadministrimit të ndërmarrjeve, raporti me të shkuarën parakapitaliste etj.

Siç u cek më parë, intervistat janë kufizuar vetëm në punëtorët e ndërmarrjeve të mëdha (mbi 50 të punësuar). Në to, si më përfaqësueset edhe numerikisht, ashtu edhe kontribut në produktivitetin e vendit janë përzgjedhur minierat, industria e ndërtimit, agro-ushqimorja (peshku), fasoneritë dhe *call center*-at. Shpërndarja e intervistave ka synuar të respektojë edhe kriteret gjeografike, prandaj ato janë bërë në Tiranë, Bulqizë, Lezhë, Berat dhe Durrës. Në këtë fazë të studimit, i cili do të vijojë gjatë gjithë 2016-s me mjaft më tepër intervista,

janë intervistuar 94 punëtorë. Për shkak të vështirësive gjatë procesit të intervistimit, shpërndarja e të intervistuarve sipas sektorëve është shpërpjesëtimore, çka do të drejtpeshohet në botimin e pjesës së dytë të studimit. Numri i intervistave të marra në *call center*-a është 29, në fasoneri 26, në ndërtim 24, në miniera 9 dhe në fabrikën e peshkut 6.

Në pjesën e fundit të punimit do të përpiqemi që rezultatet e analizës dhe interpretimit të të dhënave t'i vendosim në marrëdhënie me kontekstin e gjerë politik, ekonomik dhe ideologjik në të cilin gjendet Shqipëria në njëzetepesë vitet e fundit.

III. RISTRUKTURIMI NEOLIBERAL I SHOQËRISË SHQIPTARE

Neoliberalizmi nuk është një sistem i ri shoqëror. Ai përbën trajtën e fundit dhe deri më tash më ekstreme të marrë nga kapitalizmi. Kapitalizmi mund të kuptohet edhe si mënyrë prodhimi, edhe si formacion shoqëror. Formacioni shoqëror dallohet nga mënyra e prodhimit pasi përbëhet nga disa të tilla. Mirëpo, pavarësisht kësaj larmie, njëra prej mënyrave të prodhimit është përcaktuese në raport me të tjerat. Sidoqoftë mënyrat e prodhimit përcaktojnë vetëm aspektin ekonomik të një formacioni shoqëror. Ky i fundit ka nevojë për pushtetin politik të aparateve shtetërore dhe atë ideologjik të aparateve ideologjike. Ama, për ta thënë me Louis Althusser-in, aspekti ekonomik është më i rëndësishmi dhe përcaktuesi në instancë të fundit i dy aspekteve të tjera. Kësisoj, një formacion shoqëror përmban dy gërshetime të tensionuara: atë midis aspekteve ekonomike, politike dhe ideologjike dhe atë midis mënyrave të ndryshme të prodhimit brenda sferës ekonomike. Prandaj kur flasim për ristrukturimin neoliberal të shoqërisë shqiptare po i referohemi partikularitetit historik dhe gjeoshoqëror të kapitalistëzimit të formacionit shoqëror shqiptar në të trija aspektet e sipërpërmendura. Domethënë do të flasim për transformimin e vazhdueshëm të mënyrave të prodhimit deri në sundimin e asaj kapitaliste (të llojit neoliberal) në sferën ekonomike dhe mënyrës se si kjo e fundit është nxitur dhe konsoliduar nga raportet politike dhe ideologjike.

Përpara se të analizojmë shkurtimisht tri aspektet e mësipërme, do të ishte e nevojshme ta vendosnim Shqipërinë në gjeografinë politiko-ekonomike të atyre që teoricienët e kapitalizmit si sistem-bote i quajnë marrëdhënie të zhdrejtpeshuara midis qendrës, gjysmëperiferisë dhe periferisë së sistemit-botë kapitalist. Shqipëria, sikundër të gjitha vendet që u ndikuan në ristrukturimin shoqëror nga Revolucioni i Tetorit, u orvat gjatë socializmit despotiko-burokratik të dilte nga pozita e vendit të periferisë së sistemit kapitalist-botë. Kjo kërkonte, si në çdo vend tjetër ish-socialist, theksimin e modernizimit të sforcuar dhe të shpejtë ekonomik të bazuar në akumulimin e ethshëm shtetëror të kapitalit (në kurriz të punëtorisë, por sidomos të fshatarësisë) për të ndërtuar bazën e nevojshme industriale që do t'i rezistonte gravitacionit kah periferia ekonomike e varur dhe e prapambetur e sistemit kapitalist-botë. Dështimi ekonomik dhe politik i kësaj tentative të rëndësishme historike prej ish-Bashkimit Sovjetik e kudo në ish-vendet socialiste pati efektin e vet edhe në Shqipëri, çka dëftohet në krizën e thellë në të cilën hyri ekonomia burokratike socialiste në dhjetëvjeçarin e fundit. Ndërrimi i formacionit shoqëror e krodhi Shqipërinë në pozitën e një vendi të integruar në sistemin-botë kapitalist që karakterizohet nga një proces çindustrializimi, ekonomi e vogël e mbijetesës, emigrim masiv i fuqisë punëtore, remitanca, shitje progresive e pasurive publike, krijim i një borgjezie kryesisht tregtare dhe të lidhur kompromentueshëm me shtetin etj.

Pas kësaj paranteze, logjika e do që t'ia nisim me aspektin ekonomik. Mirëpo përparësia logjike e ekonomisë nuk nënkupton medoemos përparësinë kronologjike të saj. Më konkretisht, formacioni shoqëror kapitalist

shqiptar nisi të përvijohet në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar, me rrëzimin e socializmit despotiko-burokratik. Fitili ndezës i procesit të kapitalistëzimit (neoliberal) të ekonomisë gjendet në thyerjen e raporteve të pushtetit politik, pra në rrëzimin e elitës politike të formacionit shoqëror të kaluar. Ndodhi revolucioni antidespotiko-burokratik, pa nisi reformimi kapitalist i marrëdhënieve të prodhimit. Sigurisht që ekonomia mund të konsiderohet edhe kronologjikisht si shkak "negativ", në kuptimin se socializmi despotiko-burokratik nuk do të mund të përmbysesh pa krizën e thellë ekonomike që e pllakosi dhjetëvjeçarin e fundit të vet, pa pakënaqësinë e madhe shoqërore që ushqente rezistencën politike. Gjithsesi akti i parë thyerës është gjithmonë politik.

Ironia e historisë e do që thyerja politike e socializmit despotiko-burokratik të vinte nga klasa mbi të cilën trumbetohej se e kishte bazën: klasa punëtore. Pavarësisht se rezistenca ndaj regjimit nisi me studentët dhe intelektualët e Tiranës, situata mori hov të papërballueshëm politik gjatë muajve të parë të vitit 1991 kur protestës iu bashkuan qytetarët, sidomos punëtorja. Fill pas zgjedhjeve të marsit 1991, të fituara bindshëm nga PPSH-ja, punëtorja e qyteteve të mëdha, e sapoorganizuar në sindikata të pavarura nga shteti, kreu për herë të parë dhe të fundit në historinë e Shqipërisë një grevë të përgjithshme, e cila në pak ditë solli jo vetëm rënien e qeverisë së PPSH-së, por edhe fundin e regjimit të vjetër. Mirëpo e pamësuar me organizimin e pavarur, me shpresa utopike se e ardhmja josocialiste do të ishte medoemos shumë më e mirë se e shkuara e sapolënë pas, klasa punëtore shqiptare me këtë akt heroik shënoi edhe fundin e vet, fillimisht politik e paskëtaq ekonomik. E futur nën sqetullën e burokracisë së re sindikale dhe Partisë Demokratike, ajo nuk arriti t'i bënte ballë ristrukturimit kapitalist neoliberal të 1992 e këtej, duke zgjedhur në vend të rezistencës së organizuar emigrimin e çorganizuar. Kjo shpjegon edhe disfunkcionalitetin shoqëror të një klase punëtore që punon e shfrytëzohet në Perëndim, por konsumon pjesërisht në Shqipëri (remitancat).

Siç do ta shohim në trajtimin e ristrukturimit ekonomik, ngjarjet revolucionare të 1991 prodhuan kundërtëhënshëm çindustrializim, papunësi masive, shpërbërje të klasës punëtore tradicionale dhe formave të organizimit punëtor, emigracion, pabarazi në thellim e sipër, reduktim të një pjese të mirë të shërbimeve sociale si në mjekësi dhe arsim etj. Pakënaqësitë në rritje ndaj politikave neoliberale u fashitën disi nga mesi i viteve '90 kur, me heshtjen pranuese të institucioneve financiare ndërkombëtare me fuqi mbikëqyrëse ndaj Shqipërisë si FMN-ja, lulëzuan skemat piramidale. Në pak vite, si rezultat i qarkullimit spekulativ të parasë, një pjese të mirë të shoqërisë iu krijua mundësia e konsumit më të mirë dhe u shënua njëfarë vitaliteti ekonomik. Mirëpo falimentimi i pritshëm i tyre zgjoi revolta popullore, të cilat ideologjikisht mund të reduktohen si kundërshti ndaj humbjes imediate të parave apo komprometimit dhe autoritarizmit të qeverisë së PD-së, por që gjithsesi në nënshtratin e tyre rridhte pakënaqësia e paartikulluar ndaj të gjithë procesit të ristrukturimit neoliberal. Kësisoj në muajt e parë të pranverës nuk u thye vetëm autoriteti shtetëror, por u tentuan, pa sukses, forma të vetorganizimit qytetar. Pa përvojë demokratiko-radikale, pa ndërgjegjen e duhur politike të rrokjes sistimore të krizës dhe të nënshtruara ndaj hegjemonisë së partive opozitare të kohës (kryesisht PS-së), komitetet e shpëtimit publik e humbën shumë shpejt autenticitetin e tyre politik dhe, në vend të tyre, gëloi një situatë hobsiane e luftës së të gjitha bandave kundër njëra-tjetrës, qytet më qytet, sidomos në jug të Shqipërisë.

Situata distopike, e ngjashme me karikaturat që i bëjnë konservatorët anarkizmit, prodhoi në vetëdijen publike nevojën e rivendosjes së autoritetit shtetëror me çdo kusht, edhe pa kthimin e parave të humbura. I vetmi koncesion politik, i imponuar pjesërisht edhe nga faktorët ndërkombëtarë, ishte prapësimi i dalëngadaltë i autoritarizmit partiak të deri-1997 dhe zëvendësimi i tij me një pluralizëm elitist politik, ku herët a vonë, me pak dhunë e klientelizëm, pushteti politik mund të qarkullonte midis partive politike rivale. Po ashtu, me ardhjen e

PS-së në pushtet, çdo shpresë për alternativë ndaj neoliberalizmit mori fund dhe procesi i privatizimeve vazhdoi edhe më shpejt se në pjesën e parë të tij. Ky mund të konsiderohet si rasti i dytë ku situata revolucionare me potencial antisistemor prodhon të kundërtën e vet: theksimin e privilegjeve.

Nëse hidhemi tani në reformat ekonomike, duhet theksuar se në fillimet e veta procesi i privatizimit eci në dy shina jo medoemos të përputhshme me njëra-tjetrën ekonomikisht, por të domosdoshme politikisht për të krijuar minimumin e konsensusit shoqëror për ristrukturimin neoliberal. Në njërën anë kemi privatizimin popullor të shtëpive të banimit, çka i bëri të gjithë qytetarët e rritur pronarë të banesës. Nga ana tjetër, që më 1991 punonjësit e dyqaneve në qytete u kthyen në pronarë të tyre duke i dhënë jetë një borgjezie të vogël ende të rëndësishme në strukturën shoqërore të vendit. Po ashtu, si rezultat i rezistencës pasive të fshatarësisë ndaj ndryshimit sistemor, edhe PD-ja ra dakord që ligji për shpërndarjen e tokës bujqësore të ruante logjikën e reformës socialiste të tokës më 1946, duke e ndarë këtë të fundit familjarisht për frymë. Diçka e tillë çoi në krijimin e një klase të gjerë fshatarësh pronarë të vegjël toke, paçka se në të shumtën e rasteve copëzimi i saj, mungesa e kapitaleve investuese dhe e teknologjisë moderne bëri që rendimenti i tokës të ishte shumë i ulët dhe të nxiste migrimin e brendshëm e të jashtëm dhe shndërrimin e një pjese të fshatarësisë në klasë të re punëtore qytetesh. Nga ana tjetër, nisi procesi i privatizimit të kapitaleve prodhuese shtetërore, sidomos i ndërmarrjeve dhe fabrikave, fillimisht i të voglave dhe të mesmeve. Që në krye të herës u vendos mbyllja e ndërmarrjeve që konsideroheshin jorentable dhe të paprivatizueshme. Të tjera u privatizuan në forma nga më jotransparentet dhe korruptive saqë jo vetëm nuk i rivitalizuan ato, por edhe i shkatërruan duke ua ndryshuar tërësisht qëllimin. Sipas studiuesve Lulzim Hana dhe Ilia Telo, "...shumë ndërmarrje të vogla, të mesme dhe të mëdha (aq sa janë privatizuar) e kanë transferuar të drejtën e pronësisë pothuajse me çmime simbolike. Në fillimet e procesit të privatizimit, me qëllim që ky të përparonte me shpejtësi, nga shtetarët tanë u theksua se 'vlerësimi i ndërmarrjeve nuk duhet të jetë një qëllim në vetvete dhe nuk duhet të jetë shkak për vonesat në privatizim. Këto vonesa nuk janë produktive'."⁵ Nënçitimi shpalos edhe argumentin ideologjik të privatizimeve të shpejta, pjesë e pandashme e doktrinës neoliberale: Edhe ndërmarrja më e keqe private është më efiçente dhe produktive për ekonominë sesa më e mira ndërmarrje publike. Sigurisht që realiteti i tjetërsimit të tyre tregon se doktrina ishte kthyer në dogmë.

Duhet thënë se që më 1992 udhërrëfyese të reformave të qeverive shqiptare kanë qenë institucione ekonomike dhe financiare ndërkombëtare si FMN-ja dhe Banka Botërore. Sipas dogmës neoliberale, industritë që nuk i rezistonin dot konkurrueshmërisë në rritje globale nuk duheshin mbështetur, çka do t'i shtynte kapitalet të orientoreshin në degë fitimprurëse, të cilat s'kishin pse të ishin medoemos produktive industrialisht. Pasojë e pashmangshme e këtyre politikave ishte çindustrializimi në të gjitha aspektet e tij: reduktim drastik i numrit të ndërmarrjeve industriale, i prodhimitarisë së tyre dhe i të punësuarve në to.⁶ Pavarësisht këtyre regreseve,

⁵ Hana, Lulzim. Telo, Ilia. (2005). *Tranzicioni në Shqipëri: Arritje dhe sfida*. Tiranë: Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Ekonomisë, f. 139

⁶ "Nga 339 mijë punonjës në degën e industrisë në vitin 1990, numri i tyre ra në 79 mijë në vitin 2004 ose mbi 4 herë. Rënie e tillë e nivelit të prodhimit dhe të punësimit nuk vërehet në asnjë vend tjetër të bllokut lindor." Po aty, f. 223 Të njëjtët studiues marrin si shembull domethënësinë e industrisë minerare, dikur industria më efiçente e ekonomisë socialiste, e aftë për të mbuluar humbjet e sektorëve të tjerë: "Shqipëria ishte ndër 4-5 eksportuesit kryesorë botërorë të kromit. Tri miniera, dy uzina të ferro-kromit, një fabrikë pasurimi dhe një impiant seleksionimi i kësaj dege iu dhanë në shfrytëzim me koncesion firmave të huaja, me synim që të rritej cilësia e punës. Por rezultatet nuk janë ato që priteshin. Gjithashtu janë mbyllur dhe kanë kaluar në privatizim asetet e rreth 30 minierave. Si

institucionet ndërkombëtare deri në vitin 1996 e merrnin Shqipërinë për modelin e reformave neoliberales, shembullin që duhej ndjekur edhe nga vendet e tjera. Mirëpo siç vë në dukje studiuesi Daniel Vaughan-Whitehead: “Vullneti i qeverisë Berisha për të zbatuar reformat dhe për t’iu përshtatur kërkesave të FMN dhe Bankës Botërore, e lidhur kjo me vullnetin e ekspertëve të huaj për ta paraqitur Shqipërinë si histori suksesi, duket se e kanë maskuar realitetin në të cilin suksesi i dukshëm ekonomik varej në një masë të madhe nga remitancat prej punëtorëve emigrantë, kontrabanda e gjerë dhe pastrimi i parave, dhe fitimet afatshkurtra iluzore nga skemat piramidale.”⁷

Një situatë e tillë ka prodhuar papunësi masive e cila, nga ana e saj, e vështirëson në maksimum organizimin sindikal të punëtorëve. Megjithatë shifrat zyrtare të papunësisë e nxjerrin këtë të fundit problematike, por jo ekstremisht të tillë, shifra reale, që përfshin edhe punëtorët që punojnë me kohë shumë të pjesshme apo fshatarët që nuk kanë mundësi ta punojnë tokën, mund të arrijë deri në 40% të popullsisë aktive për punë. Kjo ka bërë që shifrat zyrtare të organizimit sindikal të punëtorëve të kenë pësuar rënie drastike. Mjafton të përmendim këtu faktin se deri në vitin 1997, niveli i sindikalizmit kishte rënë nga 93% në 12%.⁸ Sot ky nivel është i papërfillshëm numerikisht, madje shifra zyrtare nuk gjenden. Për më tepër, edhe ata pak punëtorë të sindikuar i përkasin më së shumti sektorit publik ose, më saktësisht, janë të regjistruar në njërën prej federatave (konfederatave) sindikale shtojca të dy partive të mëdha politike. Për pasojë niveli i veprimit të tyre sindikal ka qenë thuajse i padukshëm.

Siç u cek më lart, fitorja e PS-së në zgjedhjet e 1997-s, ndryshe nga pritshmëritë popullore, solli thellimin e reformave neoliberales të cilat, me rifutjen e fortë të FMN-së në lojë, nisën me privatizimin e ndërmarrjeve të fundit prodhuese ose mirëmbajtëse shtetërore. Me ligjin "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" të 1998 iu hap rruga privatizimeve të sektorëve strategjikë si në transport, telekomunikacion, energjetikë etj, si edhe dhënia me koncesion e të drejtës së shfrytëzimit të pasurive minerare dhe hidrokarbure. Qeverisja e re e PD-së pas 2005 e vazhdoi këtë rrugë, duke i shtuar edhe masën ekstreme neoliberales të taksës së sheshtë 10% si për fitimet, ashtu edhe për të ardhurat nga puna. Sakaq, qeveria aktuale e PS-së në shtator të 2015-s hodhi një prej hapave të fundit neoliberalizues, tregtarizimin e logjikës së funksionimit të universiteteve publike dhe orientimin e fondeve shtetërore drejt universiteteve private.

Afërmendsh, të tilla efekte nuk do të mund të prodhoheshin pa ndihmën e ideologjisë, pra pa prodhimin e një tërësie botëkuptimesh, përfytyrimesh, vlerash dhe besimesh shoqërore që do të nxisnin pranimin si të pashmangshme të kësaj rrjedhe historie. Për të kuptuar më thellë procesin e ideologjizimit neoliberal na duhet ta ndajmë çështjen në tre plane: i pari, më konceptual, do të trajtojë shkurtimisht në mënyrë kritike nyjet e ligjërimit politik hegjemonist, kurse i dyti do të merret me transformimet programore të dy partive kryesore qeverisëse, PD dhe PS, në këta vjet, duke theksuar mënyrën se si i janë qasur klasës punëtore.

rezultat, nga mbi një milion tonë prodhim mineral kromi, 316 mijë tonë mineral kromi i pasuruar dhe 156 mijë tonë koncentrat që prodhohej në vitin 1990, sot prodhohen sasi të papërfillshme... Nga viti 1995 e deri më sot kanë kaluar në procesin e mbylljes dhe të privatizimit rreth 140 miniera e sektorë, gjë që tregon qartë se industria minerare po shkon drejt shuarjes.” – Po aty, f. 224-225

⁷ Vaughan-Whitehead, Daniel. (1999). *Albania in Crisis. The Predictable Fall of the Shining Star*. Massachusetts: Edward Elgar, f. 16

⁸ Shih: Po aty, f. 301

Pikësëpari duhet thënë se ideologjia ka për funksion dhe efekt të riprodhojë logjikën sunduese të një formacioni shoqëror, përkatësisht mënyrën kapitaliste të prodhimit. Prandaj që në fillimvitet '90 krijohet një përfytyrim publik manikeist që bashkë me regjimin e vjetër (socializmin despotiko-burokratik) hidhte poshtë çfarëdo arritjeje social-ekonomike parakapitaliste dhe e konsideronte sa katastrofike ekonomikisht, aq edhe të tmerrshme politikisht çdo tentativë të ardhshme të vendosjes në dyshim të kapitalizmit si të tillë. Mirëpo në Shqipëri nuk u vendos një sistem kapitalist i çfarëdoshëm, por – në përputhje me logjikën globale të zhvillimit të kapitalizmit, sidomos në vendet e periferisë – një kapitalizëm i përparimit të pandalshëm të logjikës neoliberale. Kështu ideologjia nuk do të djallëzonte apo prodhonte si aventurë vetëm alternativat ndaj kapitalizmit, por edhe alternativat ndaj neoliberalizmit brenda vetë marrëdhënieve kapitaliste të prodhimit. Prandaj, me kalimin e kohës, me konsolidimin në pushtet të elitës së re politike, me zbrapsjen e pjesëmarrjes masive në jetën politike të vendit dhe, sidomos, me shpërbërjen shoqërore dhe organizative të klasës punëtore, ideologjia sunduese nisi të konsiderojë të pamundur çfarëdo dimension të serioz shteti social dhe po ashtu çfarëdo ligjërimi që do të mbështeste qoftë edhe të drejtat minimale për punëtorët.

Nga ana tjetër, ideologjia nuk mund të kishte karakter hegjemonik nëse përmbajtjen e saj ekonomiko-shoqërore nuk do ta lidhte me një që do të zgjonin imagjinatën dhe dëshirat e masave. Këtë funksion e kanë luajtur idetë e Perëndimit dhe Evropës. Sërish sipas logjikës dikotomike, kapitalizmi neoliberal ishte shtegu drejt investimeve të kahershme të dëshirave popullore (utopitë subversive të kohës së socializmit despotiko-burokratik) drejt begatisë së përtejdetit, në kundërshti me një inerci aksidentale historike të përkundërt: trinisë osmanizëm – greko-serbizëm – komunizëm. Në këtë kontekst, në varësi të nënndarjeve ideologjike, kundërshtarët e kapitalizmit neoliberal do të gjendeshin të çiftuar me së paku dy nga tri elementët e mëposhtëm. Për nacionalistët dhe konservatorët, antiperëndimorizmi nënkuptonte tradhti kombëtare komuniste në interes të grekëve dhe serbëve, kurse për liberalët boshti i të keqes ishte osmanizëm-komunizmi. Edhe kur kauza punëtore nuk anatemohej drejtpërdrejt, ajo mbytej në heshtje duke tejtheksuar debatet kulturaliste të identitetit të shqiptarëve, rolit të fesë dhe kombit etj.

Zhdukja e çështjes punëtore dhe e dimensioneve serioze të shtetit social mund të vihet re edhe në zhvillimin ideologjik të programeve të partive politike. Kështu, në PD transformimi ka qenë më i shpejtë dhe i dukshëm. Në vitin 1991 ajo kërkon të vendosë hegjemoni kulturore duke interpretuar pakënaqësitë ekstreme të masave shoqërore, sidomos të punëtorisë, ndaj burokracisë socialiste. Në atë vit në Rilindjen Demokratike gjejmë vend edhe kritika me frymëzim teorik trockist apo punëtorist (*workerist*) ndaj shfrytëzimit ekonomik të punëtorëve nga burokracia e privilegjuar socialiste. Po ashtu, para ardhjes në pushtet tranzicioni drejt kapitalizmit premtuhej i butë që të mos trembte sidomos punëtorinë. Edhe një fajkua i neoliberalizmit si Gramoz Pashko, asokohe nënkryetar i PD-së, mund të shkruante më 1991: "Punëtorët që do të humbasin vendet e punës deri në hapjen e vendeve të reja mund të marrin të paprekur pagën e tyre nga fondi që transferohet nga subvencionet ndaj ndërmarrjeve, nga kursimi i materialeve që sot në shumicën harxhohen në mënyrë parazitare, nga ulja e moshës së pensioneve, nga zgjatja e lejes së lindjeve për gratë, nga shtimi i një dite pushimi javor të paguar"⁹ Fill pas fitores në zgjedhjet e 1992-shit, çështja punëtore zhduket, ndërsa elementët e shtetit social janë krejt marginalë.

Transformimi ideologjik i PS-së është më i gjatë dhe më kompleks për dy shkaqe: së pari inercia ideologjike e socializmit ndikonte në mbajtjen e njëfarë ritmi punëtorist dhe shteti social në ligjërimin e saj publik; së dyti, ekzistonte domosdoshmëria për t'u dalluar nga PD-ja qeverisëse, sidomos nga radikaliteti me të cilat ajo po e

⁹RD. 5 janar 1991, Nr. 1. F. 6: Gramoz Pashko - Situata është e rëndë, por jo pa rrugëdalje

çonte përpara procesin e neoliberalizimit. Kështu në fillimet e veta, veçanërisht në vitet 1991-1992, PS-ja ushqeui shpresën shoqërore të një kapitalizmi të ekonomisë së përzier, ku ndërmarrjet shtetërore do të ndihmoheshin të zhvilloheshin dhe të bëheshin të konkurrueshme, duke i dhënë përgjigje në letër pllakosjes së papunësisë që buronte nga privatizimi çindustrializues.¹⁰ Po ashtu deri në vitin 1994 në ligjërimin e PS-së ndihej njëfarë theksimi i kauzës punëtore, kulmi i të cilës u arrit me demonstratën tronditëse të punëtorëve të uzinës shtetërore të Poliçanit më 1992 të cilët kundërshtonin shkurtimet masive nga puna si rezultat i pretendimit qeveritar të vënies në efikasitet të ndërmarrjeve në kurriz të punëtorëve. Në vitin 1994, Zëri i Popullit mund t'i lejonte vetes një kritikë të fortë të mungesës së organizimit sindikal të punëtorëve, të pamundësuar nga qeveria drejtpërdrejt përmes kërcënimeve ose tërthorazi përmes politikave ekonomike shpunësuese.¹¹ Gjithsesi që më 1995, me parullën e re ideologjike të hedhur nga kryetari Nano "Jo më socializëm demokratik, por iniciativë e lirë plus solidaritet social", PS-ja nisi të zhvendosej hovshëm djathtas. Kongresi i 1996 shënoi sanksionimin e këtij parimi, kurse nga ardhja në pushtet më 1997 e këtij karakteri neoliberal i programit të PS-së dallon gjithnjë e më pak nga ai i PD-së.

Sidoqoftë, edhe në kushtet më të vështira për organizim, reagimet punëtore nuk kanë munguar. Nuk është fjala vetëm për momentet e para të hyrjes në fuqi të politikave neoliberale, por edhe në vazhdim. Me privatizimin e plotë të sektorëve prodhues, rezistenca punëtore ka qenë e vogël dhe me efekte të pakta, por ekzistuese gjithsesi. Si shembullin më masiv mund të përmendim grevën e urisë së minatorëve të Bulqizës në verën e vitit 2011. Asokohe minatorët e zhvendosën për disa ditë protestën edhe në parkun përpara Piramidës në Tiranë, paçka se kauzën e tyre u tentua ta mbysë zhurma qytetariste (ojëfëiste) e organizimeve për kundërshtimin e planit të qeverisë së kohës për shkatërrimin e Piramidës. Ky qytetarizëm, produkt i reduktimit në pakuptimësi të kauzës punëtore, e shprehu shpërfilljen e vet në një protestë qindravetëshe mu buzë punëtorëve të shtrirë nga lodhja dhe dëshpërimi në barin e parkut, pa e kthyer asnjëherë vëmendjen nga ta.

¹⁰ "Ne e kuptojmë se reformat e këtij transformimi të thellë janë të vështira dhe do të krijojnë tronditje sociale, por ne synojmë dhe kërkojmë nëpërmjet iniciativave legjislative parlamentare, që zgjidhjet juridike që nxisin reformat ekonomike të respektojnë interesat e shumicës së popullit, të sigurojnë mekanizma të mbrojtjes sociale të kushteve të domosdoshme të jetesës dhe mbi të gjitha të sigurojnë integritetin real të shumicës së njerëzve në proceset demokratike." – ZP. 15 tetor 1992, f. 1: Fatos Nano (intervistë) - Ne kërkojmë shanse të barabarta për të gjithë shqiptarët

¹¹ "Por ata sot ndihen të përçarë e të tradhtuar nga sindikatat që kanë për detyrë t'i mbrojnë. Çdo ditë po flitet e shkruhet për përçarjen e sindikatave, për servilizmin dhe nënshtrimin e tyre para qeverisë, për pamundësinë e organizimit të punonjësve etj. Kjo gjendje e organizimit të punonjësve shqiptarë është krijuar nëpërmjet një strategjie të përcaktuar qartë nga pushteti i sotëm, sepse vetëm kështu pushteti mund të veprojë si të dojë, pa patur shqetësime nga punonjësit" – ZP. 1 maj 1994, f. 1: Editorial - Sot 1 Maji



Ole Elfenkämper, Bulgizë 2012

Po ashtu nuk kanë munguar as grevat e atypëratyshme të punëtorëve, sidomos për kushtet e vështira në punë dhe mosdhënien prej muajsh të pagave nga punëtorët. Vlen të veçohet këtu protesta e punëtorëve të fabrikës së përpunimit të peshkut Eurofish në Lezhë më 2011, protesta e naftëtarëve të ARMO-s në Ballsh apo ajo e punëtorëve të hidrocentralit të Banjos. Në dy protestat e fundit ka pasur edhe ndërhyrje grevëthyesë të policisë, e cila ka ushtruar dhunë ndaj punëtorëve grevistë e protestues.¹² Megjithëse raportimi gazetaresk nuk ka munguar në këto raste, mënyra e trajtimit të çështjes ka lënë gjithnjë në heshtje shkaqet sistemore duke i dhënë zë momental vetëm ankesës së drejtpërdrejtë.

IV. LEGJISLACIONI PËR TË DREJTAT E PUNËTORËVE

Një nga nënçështjet e këtij punimi është kuptimi i respektimit të të drejtave që punëtorëve ua njeh ligji dhe niveli i ndërgjegjësimit të tyre për ekzistencën e këtyre të drejtave. Ndaj duhet të themi dy fjalë për kuadrin ligjor që merret me të drejtat e punëtorëve. Fillimisht duhet pohuar se megjithëse shteti dhe ligji kanë për funksion garantimin e përjetësisht të marrëdhënieve të pabarabarta klasore, formaliteti i ligjit nuk shkon përpara me të njëjtin ritëm si raportet ekonomike. Nëse në këto të fundit shfrytëzimi dhe kërcënim i është i plotë dhe i papenguar, kuadri ligjor mbart kontradiktën e nxitjes në njërën anë të ristrukturimit neoliberal të ekonomisë, ndërsa në anën tjetër flet për disa të drejta të sigurisë në punë dhe të organizimit punëtor të cilat, nëse do të zbatoheshin deri në fund, do ta fusnin në krizë kapitalizmin neoliberal. Gjithsesi shteti e zgjidh këtë kontradiktë duke i konsideruar të drejtat ligjore thjesht formale dhe pa marrë angazhim të përfillshëm në materializimin e tyre.

Nëse e nisim me kushtetutën, do të vëmë re se, përveçse garantohet liria e punëtorit për ta shitur fuqinë e tij punëtore, flitet edhe për të drejta me potencial subversiv si ajo e organizimit sindikal apo grevës. Kështu pika 2 e nenit 49 i siguron punëtorit të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës. Ndërsa në nenin 50 thuhet se kushtetuta i jep të drejtën çdo punëtori të organizohet lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës, si dhe garanton të drejtën e të punësuarit për grevë që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës. Po ashtu, kreu V i kushtetutës përcakton objektivat sociale të organizimit politik të shoqërisë. Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private synon: punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë; standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm; një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Karakteri ideologjik i këtij neni gjendet në moskonsiderimin e të mësipërmeve të drejta bazike shoqërore, por si objektiva sociale, çka nënkupton se ato nuk kanë karakter detyrues për qeveritë, por shërbejnë vetëm si pikësynime të vagullta fakultative.

Nga ana tjetër, Kodi i Punës, ligji më i lartë i rregullimit të marrëdhënieve në punë, pavarësisht anësisë që mban në dobi të pronarëve, u njeh punëtorëve të drejta të rëndësishme. Kështu në nenin 38 parashikohet se punëdhënësi duhet të vërë në dispozicion të punëmarrësve në çdo ndërmarrje një kopje të Kodit të Punës, pra t'u mundësojë realisht njohjen e të drejtave të tyre. Për sa i përket sigurisë në punë, kodi përcakton se punëdhënësi duhet të përcaktojë qartë rregullat e sigurimit teknik për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet profesionale. Punëdhënësi duhet të paguajë diferencën midis dëmit dhe shpërblimit që merr punëmarrësi nga sigurimet shoqërore kur aksidenti ose sëmundja profesionale vjen si pasojë e fajësisë së rëndë

¹² Shih: Panorama. 26 gusht 2014 "Protestë për pagat, policia shoqëron në komisariat katër punonjës se HEC-it të Banjos"; Panorama. 22 mars 2011 "Punëtorët e Eurofish-it përplasen me policinë"

të punëdhënësit. Kur punëdhënësi nuk ka regjistruar punëmarrësin në sigurimet shoqërore, ai duhet të përballojë të gjitha shpenzimet që ka bërë punëmarrësi si rezultat i aksidentit ose sëmundjes profesionale, si dhe të gjitha dëmet si pasojë e mosregjistrimit. Me rëndësi të veçantë është pika 1 e nenit 43 e cila i detyron punëdhënësit të informojnë punëmarrësit mbi rreziqet që lidhen me punën dhe duhet t'i kualifikojë punëmarrësit për respektimin e kërkesave në fushën e shëndetit, sigurimit dhe higjienës. Pika 3 e këtij neni përcakton se punëdhënësi duhet t'u shpjegojë punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve domosdoshmërinë e zbatimit të masave të sigurimit teknik dhe higjienës. Po ashtu, për sa u përket të drejtave për organizim dhe reagim, pika 4 e nenit 197 ndalon çdo veprim që përfshin shtrëngim, cenim ose diskriminim ndaj punëmarrësve për shkak të pjesëmarrjes ose jo në grevë.

Përveç legjislacionit me burim të brendshëm, në sektorë të caktuar si minierat janë ratifikuar konventa ku parashikohet mbrojtje e veçantë për punëtorët. Ky është rasti i Konventës mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Miniera e ratifikuar më 1995. Nga ajo mund të veçohen këto detyrime të punëdhënësit që implikojnë të drejta të sigurisë për punëtorët: "Duke marrë masat e parandalimit dhe të mbrojtjes të parashikuara nga kjo pjesë e Konventës, punëdhënësi duhet të vlerësojë rreziqet dhe t'i trajtojë ato sipas një renditjeje prioritare, si më poshtë: eliminimi i këtyre rreziqeve, të kontrollohen qysh në burim, të zvogëlohen në minimum me mjete të ndryshme hartimi i metodave të tyre të punës të jenë të sigurt." Nga ana tjetër, punëdhënësi duhet të sigurojë që mbikëqyrja e rregullt mjekësore e punëtorëve të ekspozuar ndaj rreziqeve profesionale të ushtrohet sipas parimeve të përgjithshme të mjekësisë së punës dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar.

V. INTERVISTAT

Nga 65 pyetjet që u janë drejtuar punëtorëve, në këtë fazë të analizës dhe interpretimit të intervistave kemi përzgjedhur 16 syresh, të ndara në katër blloqe kuptimore: *Kushtet e punës dhe respektimi i të drejtave punëtore; marrëdhëniet klasore brenda vendit të punës; kushtet e jetesës dhe gjendja ekonomike e punëtorëve dhe familjeve të tyre; ndërgjegjja klasore e punëtorëve*. Analiza dhe interpretimi i intervistave do të kryhet pyetje pas pyetjeje duke vendosur në raporte ndikimi përgjigje të ndryshme ose duke hedhur hipoteza mbi domethënien e disa prej tyre duke marrë në konsideratë si njohuritë për kushtet e përgjithshme social-ekonomike të Shqipërisë, ashtu edhe metodën e kritikës së ideologjisë që shfaqet në përmbajtjen dhe logjikën e përgjigjeve punëtore.

5.1 Kushtet e punës dhe respektimi i të drejtave punëtore

Këtë çështje do ta shtjellojmë duke analizuar dhe interpretuar përgjigjet e pyetjeve në vijim:

1. Sa orë në ditë punoni?

Në figurën 1 jepen orët e punës në ditë të ndara sipas sektorëve të punësimit, të cilat në vlerat e tyre mesatare vërtiten rreth 8-orarëshit, çka në dukje është konform Kodit të Punës, por që po të shikohen të dhënat absolute numri i orëve të punës fillon nga 4 orë në ditë (*call center*) deri në 12 orë në ditë (ndërtim). Nga grafiku bie në sy se në *call center*-a mesatarja e orëve të punës është 5.25 orë në ditë, por që kjo shpjegohet me faktin se 90%

e të intervistuarve të këtij sektori janë studentë. Këtu nuk mund të shtrohet pyetja se a shfrytëzohen në punë studentët, por se kur e gjejnë kohën për të ndjekur studimet?




Figura 1: Sa orë në ditë punoni?

2. A punoni orë shtesë? A paguhen ato?

Në figurën 2 jepet numri i punëtorëve që punojnë orë shtesë dhe numri i punëtorëve që paguhen për orët shtesë. Ajo që bie në sy është se, përveç sektorit minerar (ku rreth 22% e punëtorëve punojnë jashtë orarit të kontratës së punës), në sektorët e tjerë kemi një përqindje shumë të lartë të punëtorëve që punojnë jashtë orarit zyrtar. Nga ana tjetër ia vlen të theksojmë se këto orë shtesë paguhen në një masë të konsiderueshme, nga 85% në sektorin fason deri në 100% në sektorin minerar e peshkim. Si shpjegohen këto dallime? Ndoshta në sektorin minerar fakti që ka një traditë sindikaliste mund të jetë një shpjegim se përse në këtë sektor punohet më rrallë jashtë orarit dhe paguhen në masën 100%. Ndërsa në sektorin fason shpjegimi se përse haset nivel më i ulët i pagesës së orëve jashtë orarit mund të vijë prej faktit se këtë sektor nuk ka traditë sindikaliste dhe janë të punësuar në një masë shumë të madhe gra, dhe për më tepër me arsim tetëvjeçar dhe të mesëm. Fakti që kjo hipotezë e fundit nuk verifikohet edhe në sektorin e peshkimit, ku kemi të njëjtën strukturë të të punësuarave, mund të vijë prej gabimit statistikor pasi numri i intervistave në sektori e peshkimit është shumë i vogël dhe më pak i besueshëm në krahasim me sektorin fason.

Të dhënat cilësore nga intervistat në fasoneritë e Beratit na ndihmojnë për të sjellë në vëmendje specifikat e mbipunës dhe pagimit të saj. Punëtorët e intervistuar deklarojnë se është e zakonshme që me urdhër të pronarit të punojnë deri në 15 orë shtesë në javë, çka bie ndesh me kushtin e Kodit të Punës (neni 90, pika 2) që punëtorët të mos detyrohen të punojnë më shumë se 10 orë shtesë në javë. Tjetër shkelje e pronarëve është pagesa e mbipunës. Megjithatë Kodi i Punës (neni 91, pika 1) vendos kushtin që ora shtesë e punës të mos paguhet nën shtesën 25% të orës normale të punës, në rastin e fasonerive pagesa shtesë për orë shkon deri në 18%.




Figura 2: Numri absolut i punëtorëve që punojnë orë shtesë sipas sektorëve (përqindja në emërtesë tregon: numrin e punëtorëve që punojnë orë shtesë ndaj totalit të punëtorëve, për shembull për call center është 21/29), si dhe numri i atyre që paguhen për orët shtesë

3. Sa ditë pushimi keni në javë?

Nëse i referohemi figurës 3 në lidhje me ditët pushim gjatë javës, rreth 75% e punëtorëve të intervistuar kanë vetëm një ditë pushim në javë ; nga 1 deri në 2 ditë kanë vetëm 3% ; 12% e tyre bëjnë ditë pushim. Ndërsa 7% nuk kanë pushim fare. Në fund 3% përgjigjen me “varet”, që do të thotë me raste ose sipas dëshirës së punëdhënësit.




Figura 3: Shpërndarja e pushimit javor

Sektorët ku punohet më shumë janë ndërtimi, ku 65% e punëtorëve kanë vetëm një ditë pushim dhe 35% e tyre nuk kanë asnjë ditë pushim; fasoneria, ku të gjithë të intervistuarit kanë vetëm një ditë pushim; peshkimi, ku kanë vetëm një ditë pushim; në call center 69% kanë vetëm një ditë pushim, ndërsa pjesa tjetër kanë nga 1-2 ditë ose 2 ditë pushim, ose dhe nga ata që thonë “varet” nga punëdhënësi. Ndërsa në miniera 94% e punëtorëve kanë 2 ditë pushim dhe 4% ka 1 ditë pushim. Shih figurën 4!




Figura 4: Shpërndarja e ditëve të pushimit javor në raport me sektorët e punësimit

Ky abuzim me oraret e punës dhe shfrytëzim vjen edhe si pasojë e moskontrollit nga ana e organeve kompetente, të cilat duhet të bëjnë inspektime në sipërmarrje për të parë nëse respektohet Kodit i Punës, kontrata apo detyrimet e tjera. Neni 38 i Kodit të Punës thotë: “Kohëzgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë”. Kurse neni 58 i të njëjtit kod pohon se “pushimi javor është jo më pak se 36 orë, prej të cilave 24 orë janë pa ndërprerje”. Fakti që këto të drejta respektohen vetëm në sektorin minerar lidhet me historinë dhe kapacitetet organizative sindikaliste të minatorëve. Pra organizimi sindikal ndikon mjaft edhe në respektimin e të drejtës ligjore bazike të ditëve të mjaftueshme të pushimit në javë.

Nga të dhënat e nxjerra prej intervistave gratë janë më shumë të prekura nga abuzimi me pushimet javore. Nga ata që kanë vetëm një ditë pushim, rreth 61% janë gra. Nga ata që kanë 2 ditë në javë pushim, raporti është i përbysur, pra 73 % janë burra. Arsyet e kësaj pabarazie duhen kërkuar gjithashtu në gjendjen social-ekonomike dhe kulturore të vendit tonë: jetojmë në një shoqëri me vlera patriarkale, ekonomikisht të pazhvilluar, ku gratë janë si sociologjikisht ashtu dhe ekonomikisht më të përjashtuara, shtypura e, për rrjedhojë, më të nënshtruara ndaj autoritetit – në këtë rast ndaj autoritetit të sipërmarrësit. Në intervistat e bëra në Tiranë shumica e të intervistuarave janë të ardhura nga rrethet, ashtu siç është shumica e popullsisë së Tiranës. Fasoneria është një sektor shumë fitimprurës, me paga të barasvlershme me pagën minimale ose poshtë saj dhe ku kryesisht punojnë gra. Në këtë aspekt këta elementë mund të jenë faktorë lehtësues të shfrytëzimit të tyre.

4. A jeni aksidentuar ndonjëherë? Pas aksidentit, a janë marrë masa nga pronari për parandalimin e rreziqeve?

Rezultatet e anketimit që lidhet me rastet e aksidenteve në punë janë domethënëse. Siç vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm (Fig. 5), sektori minerar mbetet më problematiku sa i përket aksidenteve dhe rrezikshmërisë për jetën e punëtorëve. 100% e të intervistuarave nga ky sektor u shprehën se kanë pësuar aksidente gjatë punës në të shkuarën dhe – çka është edhe më e rëndësishme – 89% thanë se njohin raste aksidentesh me pasojë vdekjen (njëri prej të intervistuarave u shpreh se është njohur me 8 raste aksidentesh vdekjeprurëse në sektorin e tij).

Edhe historikisht sektori minerar, sidomos ai i Bulqizës, është karakterizuar nga aksidente vdekjeprurëse. Nga të dhënat që kanë mbledhur vetë minatorët dëshmohet për rreth 150 vdekje minatorësh në miniera që prej vitit 1993. Madje minatorët e intervistuar dëshmojnë se në galeritë e vogla private, të administruara nga zotërit lokalë të krimit, punësohen edhe të mitur, madje ka pasur raste të vdekjes së tyre, të cilat nuk janë bërë publike si rezultat i *omertà*-së së imponuar mafioze.

Arsyet për këtë situatë janë të ndryshme. Pikësëpari, puna e minatorit mbart rreziqe objektive më të mëdha. Së dyti, pjesa kryesore e sektorit minerar është e pakontrolluar nga shteti dhe shumica e punëtorëve të përfshirë në të punojnë në mënyrë informale në kompani fantazmë të drejtuara nga gangsterë lokalë, gjë që dëshmohet edhe nga minatorët e intervistuar në Bulqizë. Pjesa tjetër shfrytëzohet nga kompani të huaja të cilat kanë bërë investime fare të papërfillshme në minierat ekzistuese sa i përket kushteve të punës dhe sigurisë në punë. Për pasojë, vdekjet në këtë sektor janë të shpeshta. Sipas të intervistuarve, pas aksidenteve janë marrë masa për parandalimin e aksidenteve në të ardhmen, por bazuar në të dhënat duket qartë se këto masa kanë qenë të pamjaftueshme.




Figura 5: Rastet e aksidenteve në punë dhe masat e marra

Sektor tjetër me përqindje të lartë aksidentesh shfaqet sektori i industrisë së përpunimit të peshkut ku punëtorët përmendin raste verbimi si pasojë e acidit që përdoret gjatë punës, si dhe shumë raste që lidhen me thyerje të gjymtyrëve për shkak të rrëshqitjeve në vendin e punës. Megjithatë, në këtë sektor nuk përmenden raste fatale. Shpenzimet në raste aksidentesh për sektorë të ndryshëm duket se janë mbuluar nga punëdhënësi në shumicën e rasteve (mbi 80%), ku përjashtim duket se bën sektori i përpunimit të peshkut me vetëm 40% të rasteve.

Interesante janë të dhënat që nxirren nga intervistat në sektorin e ndërtimit. Pavarësisht se përqindja e atyre që pohojnë se ka pasur aksidente është mjaft më e vogël se në miniera dhe industrinë e përpunimit të peshkut, kontradiktat e përgjigjeve të tyre të lënë të mendosh se numri i aksidenteve, edhe me pasojë vdekjen, është më i madh. Kështu, njëri nga punëtorët e ndërtimit që është intervistuar pohon edhe se nuk ka pasur aksidente në vendin e tij të punës, edhe se kur kanë ndodhur shpenzimet për to i ka mbuluar pronari. Nga ana tjetër,

punëtorët e ndërtimit që kanë dëshmuar për aksidente i kanë përshkruar ato në mënyrë dramatike si p.sh.: “Janë shemb e u është futur hekuri në fyt... Disa punëtorë madje vdesin nga lodhja e tepërt në punë, infarkti...” Kësisoj dëshmitë e dhimbjes punëtore dhe kontradiktat në përgjigje tregojnë jo vetëm për kushtet e punës, por edhe për marrëdhëniet pushtetore frikëndjellëse midis punëtorëve dhe pronarit.




Figura 6: Informacioni mbi sigurinë në punë

Sa i përket informacionit të nevojshëm që lidhet me sigurinë në punë (Fig. 6), nga pohimi i vetë punëtorëve duket se ata janë të informuar në të paktën mbi 60% të rasteve nga punëdhënësi. Në sektorin minerar, ku vdekshmëria është më e larta (89% e të intervistuarve thanë se njohin raste vdekjesh në punë), vërehet se informacioni mbi sigurinë është i domosdoshëm dhe e kanë 100% të punëtorëve. Megjithatë në shumë raste ky informacion është tejte i papërshtatshëm për mënjanimin dhe mbrojtjen nga aksidentet pasi nuk konsiston në procedura të specifikuar mbi mënyrën e përdorimit të mjeteve të punës apo mbi përdorimin e pajisjeve të posaçme mbrojtëse (si helmata, çizme, doreza etj.), por kryesisht në paralajmërime lidhur me mundësinë e rrezikut të pranishëm, si për shembull: “Kini kujdes nga korrenti! Kujdesuni kur hipni në skelë!” Mbi 70% e të intervistuarve shprehen se kanë mjete sigurie në punë, por këto mjete duken se janë të mbipërdorura jashtë çdo standardi të pranueshëm. Kotësia e paralajmërimeve të përgjithshme shpërfaqet në dorëzimin punëtor ndaj rreziqeve në punë. Pa mundësi tjetër mbijetese veç futjes në zgafelle, minatorët e kanë zakon ta përshëndesin njëri-tjetrin para hyrjes në minierë me urimin dëshpërues: Ardhshi shëndoshë!

5. A keni kontratë pune? – Individuale apo kolektive – me kohë të pjesshme apo të plotë?

Nga të intervistuarit në total 81% u shprehën se kanë një kontratë pune ndërkohë që 19% e tyre u shprehën se punojnë pa kontratë. Sipas sektorëve (Fig. 7) vërehet se në sektorin e ndërtimit më pak se 65% e punëtorëve kanë kontrata pune, çka përbën numrin më të ulët krahasuar me sektorët e tjerë. Ndërkaq bie në sy fakti se punëtorëve të sektorit minerar u respektohen më shumë të drejtat sa i përket kontratave në punë si dhe përqindjes së kontratave kolektive (Fig. 8). Kështu 100% e punëtorëve të këtij sektori u shprehën se kanë

kontratë dhe 67% e tyre se kanë kontrata kolektive. Kjo e dhënë mund të shpjegohet me faktin se sektori minerar është i vetmi në vend në të cilin ka pasur herë pas herë protesta për kushtet e punës, pagat etj. Sektorët me numrin më të vogël të kontratave kolektive janë ata që kanë hyrë në tregun shqiptar rishtazi dhe të cilët punësojnë kryesisht punëtorë me moshë të re: fasoneritë dhe call center-at. Kështu, në fasoneri 96% e kontratave janë individuale, ndërsa në call center-a 100% e tyre. Së bashku me sektorin e përpunimit të peshkut dhe atë të ndërtimit, në total rezultatet tregojnë së vetëm 13% e punëtorisë në vend ka kontrata kolektive.




Figura 7: Kontratat dhe njohja e të drejtave




Figura 8: Kontratat kolektive dhe individuale sipas sektorëve




Figura 9: Kontratat kolektive dhe individuale sipas gjinive

Sa i përket ndarjes gjinore (Fig. 9) dallohet se 21% e burrave përkundrejt vetëm 7% të grave kanë kontrata kolektive. Kjo vërehet edhe në figurën 8 në të cilën tregohet ndarja nëpër sektorë, ku sektorët e përpunimit të peshkut, fasonerisë dhe *call center*-ave që janë të dominuara nga punëtorët gra kanë numrin më të vogël të kontratave kolektive.

Një rezultat interesant është fakti se 16% e punëtorëve të pyetur nëse kontratën e kanë me kohë të pjesshme apo kohë të plotë, u shprehën: “Nuk e di” (Fig. 10). Kjo tregon për amullinë që ekziston te punëtorët sa i përket njohjes së Kodit të Punës dhe informacionit të domosdoshëm që duhet të kishin marrë nga punëdhënësi dhe sindikata lidhur me kontratën.




Figura 10: Kontratat me kohë të plotë dhe të pjesshme

Po të merremi me shpërndarjen në sektorë të ndryshëm, bie në sy fakti se *call center*-at kanë shifrën më të lartë të kontratave me kohë të pjesshme: 75%. Kjo shifër e lartë mund të shpjegohet me faktin se shumica e punëtorëve ndjekin njëkohësisht edhe studimet e larta dhe ky sektor u jep mundësinë e fleksibilitetit kohor

duke zgjedhur kontrata me kohë të pjesshme. Megjithatë, duke marrë në konsideratë edhe faktin se 100% e të intervistuarve në këtë sektor u shprehën se kanë kontrata individuale, si dhe e parë kjo në prizmin e kontekstit social ku papunësia te të rinjtë kap shifrën zyrtare 34% dhe mundësitë e punësimit për ta në fushën e diplomimit janë fare të vogla, rezultatet dëshmojnë për pasigurinë në vendin e punës dhe kushtet e brishta në të cilat punojnë të rinjtë në vend. Ndërkohë 78% e të intervistuarve në sektorin minerar iu përgjigjën “nuk e di” pyetjes në fjalë, çka përbën shifrën më të lartë ndër sektorët që u shqyrtuan. Ky rezultat mund të lidhet me një sërë faktorësh si mungesa e sindikatave që do ta kryenin këtë funksion, fakti se shumë prej tyre punojnë në mënyrë informale, papërgjegjshmëria e punëdhënësit për të përmbushur detyrimin ligjor të informimit të punëtorit lidhur me kontratën dhe Kodin e Punës, niveli i ulët arsimor i punëtorëve etj.




Figura 11: Kohëzgjatja e kontratave sipas sektorëve




Figura 12: Kohëzgjatja e kontratave sipas ndarjes gjinore

Rezultatet janë të ngjashme rreth punësimit me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme në aspektin gjinor (Fig. 12). Vihet re se 24% e burrave janë përgjigjur “nuk e di”, kundrejt vetëm 10% të grave. Kjo mund të lidhet me informalitetin në sektorët ku janë punësuar kryesisht burra.

6. A ju paguhen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore? A respektohet kontrata?

Nga të dhënat e anketimit rezulton se 32% e punëtorëve mendojnë se kontrata e punës nuk respektohet nga punëdhënësi, ndërsa 14% prej tyre shprehen se sigurimet shoqërore dhe shëndetësore u paguhen vetëm pjesërisht, ose nuk u paguhen fare (Fig. 13).



Figura 13: Respektimi i kontratës dhe sigurimeve

Në ndarjen sektoriale vërehet se te sektori minerar dhe ai *call center* punëtorët shprehen më të pakënaqur me respektimin e kontratës nga punëdhënësi, me më pak se 60% të të intervistuarve (Fig. 14). Sipas raportimeve nga vetë punëtorët, në *call center*-a përmenden raste të shpeshta abuzimi me orarin e punës nga punëdhënësi kur punëtorët detyrohen të punojnë më gjatë edhe pse nuk paguhen për orët shtesë. Në shumë raste të tjera raportohet se orët shtesë paguhen njësoj me orët standarde, megjithëse specifikohet ndryshe në kontratë. Në një rast punëtori u shpreh se 40 punonjës u pushuan njëkohësisht nga puna për të ushtruar presion mbi punëtorët e tjerë. Në minierë gjithashtu raportohet shpesh shkelje të kontratës sa i përket orëve të punës dhe pagës mujore. Megjithatë, në sektorin minerar punëtorët shprehen në 100% të rasteve se u paguhen sigurimet shoqërore.




Figura 14: Respektimi i kontratave dhe sigurimeve sipas sektorëve

Sidoqoftë përgjigjet për ekzistencën dhe respektimin e kontratave të punës duhen parë me sy kritik duke nxjerrë kontradiktat e përgjigjeve punëtore, të shkaktuara ose nga mosinformimi i saktë, ose nga frika për të pohuar të vërtetën. Për shembull, punëtorët e intervistuar në fasonerinë e Durrësit pohojnë se kanë kontratë pune, por nuk e kanë lexuar apo parë ndonjëherë atë. Më tej, shumica e punëtoreve të intervistuar në fasoneritë e Beratit përgjigjen se kushtet e kontratës së tyre të punës zbatohen, mirëpo njëkohësisht pohojnë se nuk e kanë lexuar kontratën në fjalë. E njëjta kontradiktë vihet re edhe në intervistat me punëtorët e ndërtimit në Tiranë. Nga ana tjetër, një punonjëse *call center*-i në Tiranë, e cila dëshmon njohuri ligjore dhe ndërgjegje klasore më të zhvilluar, dëshmon se pronari e paguan 20% më pak nga detyrimi kontraktual, duke e konsideruar këtë vjedhje. Këto dëshmi punëtore janë simptomë e hierarkisë së fortë pushtetore në marrëdhëniet e punës.

7. A jeni i kënaqur me punën që bëni?

Në figurën 15 jepen përgjigjet e kësaj pyetje për të gjithë punëtorët, por edhe sipas përkatësisë gjinore.




Figura 15: A jeni i kënaqur me punën që bëni?

Siç duket edhe nga grafiku rreth 60% e punëtorëve janë të pakënaqur me punën që bëjnë, dhe këtu burrat kanë një kontribut më të madh sesa gratë. Pyetja që shtrohet këtu është se nga se ndikohen punëtorët për të dhënë përgjigjen. Ndikohen nga niveli i të ardhurave, nga kushtet e punës e shfrytëzimi në punë, nga niveli i edukimit, nga përkatësia gjinore, nga ambiciet, nga vështirësia për të gjetur punë në profesion, nga gjendja e përgjithshme e papunësisë në Shqipëri etj? Natyrisht që për grupe të ndryshme mund të qëndrojnë arsye të ndryshme, madje edhe të kombinuara me njëra-tjetrën. Nga të dhënat e studimit rezulton se niveli i të ardhurave nuk jep një shpjegim të kënaqshëm për pakënaqësinë e punës (Fig. 16). Në vijim, pas një vëzhgimi të hollësishëm të përgjigjeve të pyetësorit dhe sidomos pas shqyrtimit të komenteve për një pyetje tjetër “Përse keni zgjedhur këtë punë?”, një arsye e mundshme që mund t’i shtyjë punëtorët të jenë të pakënaqur me punën mund të jetë fakti se shumica e të pyeturve, mbi 90%, e gjykojnë punën që kanë si të vetmen mundësi punësimi që kanë gjetur apo që mund të gjejnë në të ardhmen. Por një motiv i tillë, dhe i vetëm, nuk shpjegon ndryshimet mes sektorëve të ndryshëm të punësimit, për shembull po të krahasojmë sektorin *call center* me atë fason, ku të dy grupet shprehen se mbi 90% e kanë si mundësi të vetme punësimi, por nga ana tjetër kanë raport të përmbytur për të qenit të kënaqur ose jo në punë (Fig. 17). Më tej, mund të gjykohet se dallimi midis sektorit *call center* dhe fason mund të lidhet edhe me kualifikimin dhe nivelin arsimor: kujtojmë që në sektorin *call center* janë të punësuar punonjës me arsim të lartë, kryesisht studentë që janë ende në proces studimi, ndërsa në sektorin fason punojnë kryesisht gra me arsim tetëvjeçar dhe të mesëm. Ndërsa në një sektor tjetër, atë minierar për shembull, pakënaqësia ndaj punës mund të jetë e lidhur si me barrën e punës, por edhe me të ardhurat, duke pasur parasysh këtu që në periferitë ku ky sektor është i zhvilluar i punësuarit në minierë është e vetmja mundësi punësimi për familjen për shkak se papunësia e grave është shumë e lartë.




Figura 16: Ballafaqimi i klasave të të ardhurave me pranimin e punës




Figura 17: A jeni i kënaqur me punën që bëni? (sipas sektorëve të punësimit)

Në përfundim mund të themi se punëtorët e intervistuar, në një masë të konsiderueshme, dhe për shkaqe nga më të ndryshmet, ndihen të pakënaqur e të tëhuajsuar me punën që bëjnë. Meqenëse këta sektorë janë ndër kontribuuesit kryesorë në punësimin e sektorit privat, si dhe gjithashtu në ekonominë prodhuese dhe rritjen ekonomike, lypet një vëmendje më e madhe nga shoqëria dhe institucionet shtetërore. Natyrisht që të dhënat e deritashme duhet të pasurohen më tej, në mënyrë që të nxirren rezultate të besueshme, edhe nga pikëpamja statistikore, për shkallën e pranimin të punës dhe shkaqeve që ndikojnë në të.

5.2 Marrëdhëniet klasore brenda vendit të punës

Pas analizës dhe interpretimit të intervistave që shpalosin kushtet e punës së punëtorëve kemi shtruar pyetje për marrëdhëniet pushtetore klasore brenda vendit të punës, përkatësisht midis punëtorëve nga njëra-anë dhe pronarit/mbikëqyrësit nga ana tjetër. Ky bllok pyetjesh përfshin të mëposhtmet:

1. A ushtron presion punëdhënësi/mbikëqyrësi gjatë orarit të punës?

Kësaj pyetjeje 57% e punëtorëve i janë përgjigjur se nuk ushtron presion. Pjesa tjetër, 43%, janë përgjigjur se ka presion gjatë punës. Në tërësi nuk mund të ketë ndonjë arsye të veçantë se përse ndodh kjo sepse varet shumë nga puna dhe nga sektori ku punohet. Për shembull, në sektorin e ndërtimit, 75% e punëtorëve përgjigjen se nuk ushtrohet presion gjatë punës; ndërsa 25% thonë se ushtrohet presion. Në sektorin e peshkimit të gjithë të intervistuarit përgjigjen se nuk ushtrohet presion. Ndërsa në miniera 60% përgjigjen se ushtrohet presion, kurse 30% jo. Në fasoneri, 58% përgjigjen se ushtrohet presion dhe 42% se nuk ushtrohet. Në *call center*, 55% e të intervistuarve përgjigjen se nuk ushtrohet asnjë presion mbi ta gjatë orarit të punës, 45% përgjigjen se ushtrohet presion.

Siç mund të vërehet raporti është i ndryshëm për sektorë të ndryshëm. Në sektorin e peshkimit, ku janë zhvilluar protesta më parë, deklarohet se nuk ka presion gjatë punës. Në miniera, edhe pse punohet në kushte të vështira, ku kemi të bëjmë me një punë të mundimshme apo me një krah pune të vështirë për t'u gjetur, ushtrohet presion mbi punëtorët. Arsyeja pse kjo ndodh në sektorin minerar mund të ketë të bëjë edhe me nivelin e lartë të organizimit sindikal të minatorët, çka i shpërfaq hapur kontradiktat klasore në vendin e punës. Një element tjetër në favor të punëdhënësit, që ia mundëson të bërit presion pa pësuar gjë, është mungesa e mundësive të tjera për punë për shkak se minierat ndodhen në zona të thella malore, të përjashtuara në aspektin social-ekonomik dhe kulturor.

Në të njëjtën gjendje janë edhe punëtoret e fasonerive, ku vështirësitë e mëdha për të gjetur një punë tjetër ia mundësojnë punëdhënësit presionin apo shfrytëzimin në tërësi. Fasoneria është sektori më i keqpaguar dhe ku ka më tepër shfrytëzim për sa u përket orëve të punës dhe pagës. Për 94% të punëtorëve, paga që marrin është e pamjaftueshme ose mjafton vetëm për nevojat bazike, ndërkohë që punojnë nga 8 deri në 10; shtu këtu faktin se 78% e tyre punojnë orë shtesë, për të cilat jo të gjithë paguhen.

Call center-i është sektori që ndër të gjithë e ushqen dhe e ushtron më tepër presionin mbi punëtorin, meqenëse vetë natyra e punës bazohet te presionin.¹³ Për shembull në rastin e punës *in bound*, punëtori duhet të telefonojë klientët potencialë dhe t'u mbushë mendjen për të blerë produktin dhe për të bërë kontrata me ta. Nëse punëtori, operatori, nuk e përmbush kushtin për të bërë X kontrata në ditë, atëherë mbi të ushtrohet presion psikologjik dhe verbal në mënyrë që të arrijë objektivin e përcaktuar nga përgjegjësi apo kompania. Ka të tjerë operatorë *in bound*, të cilët telefonojnë për të kryer sondazhe të ndryshme dhe ndaj këtyre presioni është i ulët. Ndërkohë ka edhe operatorë *out bound* ndaj të cilëve nuk ushtrohet presion pasi puna e tyre konsiston në marrjen e telefonatave ose *e-mail*-eve që pak a shumë kryejnë funksionin e kujdesit ndaj klientit.

Dallimi gjinor midis atyre që deklarohen se ndjejnë presion është me interes. 60% e grave dhe 40% e burrave pohojnë se pronari/mbikëqyrësi ushtron presion gjatë orëve të punës. Ky dallim përcaktohet sidomos nga

¹³ Një punonjëse *call center*-i dëshmon se nga presioni i mbikëqyrësve ato bëhen herë pas here për të qarë.

kultura mbizotëruese patriarkale që ndërton te gratë një subjekt kokulur ndaj autoritetit jo vetëm në shtëpi, por edhe në vendin e punës.

2. A ju ka bërë presion (pronari) për të mos u organizuar në sindikata?

Presioni që punëdhënësi, përgjegjësi apo mbikëqyrësi ushtron mbi punëtorët kundër organizimit sindikal duket sikur është i papërfillshëm. Nga analiza e parë e të dhënave del se 87% e punëtorëve të intervistuar përgjigjen se nuk u kanë bërë asnjë presion për të mos u organizuar në sindikatë. Një pjesë e vogël, rreth 9 %, përgjigjet se u kanë bërë presion. 3% nuk japin përgjigje. Shkaqet e “mungesës së presionit” mund të jenë të shumëllojshme. Njëri që del nga përgjigjet është mosnjohja se ç’është organizimi sindikal¹⁴. Thua se një në katër punëtorë që deklarojnë se nuk u është bërë presion për të mos u organizuar sindikalisht deklaroi se nuk e di se ç’është sindikata. Sakaq, nga ata që e dinë, vetëm 8% deklarohen se janë të organizuar sindikalisht.

Që të dalim tek arsyet e tjera të mosndjerjes së presionit për t’u organizuar sindikalisht na duhet t’i vendosim të dhënat e mësipërme në raport me të tjera përgjigje punëtorësh. Për shembull, 57% e atyre që shprehen se nuk kanë ndjerë presion për t’u organizuar sindikalisht deklarojnë se nuk janë të kënaqur me punën që bëjnë. Sakaq, 66% e tyre shprehen se ndihen të shfrytëzuar në vendin e punës. Po ashtu 38% e tyre pohojnë se ndihen nën presion nga pronari/mbikëqyrësi gjatë orarit të punës. Nga këto të dhëna mund të dalim në përfundimin se të mosndjerit presion për të mos u organizuar sindikalisht nuk vjen nga kushtet e mira të punës. Përveç mosnjohjes së organizimit sindikal, pjesa tjetër ose nuk ka besim se ky organizim mund të sjellë përfitime (ka raste ku sindikata ekziston formalisht dhe është bashkëpunëtore e pronarit), ose ekziston frika e shprehjes së mendimit real për marrëdhënien me pronarin për sindikatën. Kjo rezultoi edhe prej faktit se 38% e atyre që nuk ndjejnë presion për mosorganizim sindikal nga pronari, ndjejnë gjithashtu presion të tjetërllotë gjatë procesit të punës. Nga intervistat është vënë re se pyetjeve mbi marrëdhëniet me pronarin apo mbikëqyrësin krijonin parehati të dukshme te punëtorët, çka vë në dyshim vërtetësinë e pohimeve delikate intervistuesve të panjohur për ta.

Një ide më të plotë të faktorëve të të ndjerit presion për mosorganizim sindikal na jep edhe ndarja në sektorë e përgjigjeve. I vetmi sektor ku dominon përgjigja se punëtorët ndjejnë presion për të mos u organizuar në sindikatë është ai minerar ku 78% e punëtorëve përgjigjen se e kanë ndjerë presionin. Nga këta të fundit 86% deklarohen se janë të organizuar sindikalisht. Pra minatorët edhe janë të organizuar sindikalisht, edhe kanë ndjerë presionin për të mos u organizuar. Nga ana tjetër rezultoi se ata i kanë bërë ballë këtij presioni. Kjo na tregon se mosndjerja e presionit për t’u organizuar sindikalisht në sektorë të tjerë buron edhe nga mospasja e përvojës apo pritshmërive për organizim sindikal. Punëtorëve që nuk u shkon ndër mend organizimi – jo se janë më pak të shfrytëzuar – nuk shohin presion pasi pronari nuk ka arsye t’i frikësohet organizimit punëtor. Puna e kualifikuar minerare, së cilës i shtohet edhe përvoja e gjatë historike e organizimit sindikal dhe ndërgjegjes klasore te minatorët e Bulqizës, bën që jo vetëm organizimi sindikal të jetë shumë më i fortë, por edhe kontradiktat klasore të jenë të ashpra dhe të dalin në sipërfaqe.

Mirëpo edhe aty ku punëtorët kanë ndërgjegje sindikale dhe ka organizim sindikal, disa prej tyre shprehen se nuk kanë besim te sindikatat aktuale, të cilat i konsiderojnë si vegla të pronarit. Për shembull një punëtorë e fabrikës së përpunimit të peshkut në Lezhë shprehet se kur vjen kontrolli nga Inspektoriati i Punës, përgjegjësjë, që aktualisht është edhe në krye të sindikatës, i udhëzon të mos bëjnë zë për kushtet e rënda të punës se “është në dëmin tuaj”. Nga ana tjetër, një pjesë e minatorëve të intervistuar në Bulqizë shprehen se kanë qenë

¹⁴ Për shembull asnjëra prej punëtorëve të intervistuar në fasonerinë e Durrësit nuk e di ç’është sindikata.

pjesë e organizimit sindikal, por e kanë braktisur atë pasi i konsiderojnë krerët sindikalë si “të blerë nga pronari”.

Nga ana tjetër, si drejtpërdrejt, ashtu edhe tërthorazi nga intervistat vihet re frika punëtore nga pronarët jo vetëm për organizim sindikal, por edhe për ngritjen e zërit në vendin e punës apo tentativat për organizim grevash apo protestash. Pavarësisht se shumica syresh mund të shprehen se nuk ndiejnë presion për t’u organizuar sindikalisht, disa punëtorë e kapërcejnë frikën gjatë intervistimit duke dëshmuar frikën në vendin e punës. Një punonjëse *call center*-i dëshmon se “kemi frikë të flasim me njëri-tjetrin për problemet e punës sepse ka shumë spiunë”. Një punëtorë e fabrikës së peshkut në Lezhë kujton se pasi tentuan organizimin e një greve vite më parë, duke bllokuar edhe rrugën, pronari pushoi nga puna 30 punëtorë. Frika dhe dëshpërimi social vihen re edhe në këto përgjigje të punëtorëve të ndërtimit në Tiranë rreth mundësisë së organizimit të grevave dhe protestave: “Edhe po të bësh grevë të heqin nga puna, se papunësia është e madhe.” “Edhe po të ngrihesh, të çon në shtëpi tjetri.” “Nëse ndodh ndonjë padrejtësi, nuk bën as protestë, as grevë. Vetëm jep dorëheqjen e lë punën.”

5.3 Kushtet e jetesës dhe gjendja ekonomike

1. Gjendja ekonomike: të dhëna të përgjithshme

Më poshtë do të merren në analizë rezultatet e pyetësorit që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike të punëtorëve të intervistuar. Në pjesën e pyetësorit që trajton kushtet ekonomike janë shtruar pyetjet e mëposhtme ndaj punëtorëve:

- Sa vetë punojnë në familjen tuaj?
- Si i vlerësoni të ardhurat personale? (me përgjigje në katër kategori: *të pamjaftueshme, të mjaftueshme, të mira dhe shumë të mira*);
- Sa janë afërsisht të ardhurat tuaja familjare? (*vlera në lekë*);
- A keni të ardhura të tjera familjare përveç pagës/pagave? (*po, jo*);
- A ju mjaftojnë të ardhurat për nevojat bazike? (*po, jo*).

Gjatë hartimit të pyetësorit u supozua se për arsye kulturore-psikologjike/mentaliteti, punëtorët do të hezitonin të jepnin një përgjigje direkte për pagën e tyre në vlerë absolute, prandaj u gjykua që kjo pyetje të relativizohej në katër kategori (*të pamjaftueshme, të mjaftueshme, të mira dhe shumë të mira*), dhe, më tej, të tentohej që të merreshin të dhëna në vlerë absolute për të ardhurat familjare. Të ardhurat familjare, nga ana tjetër – edhe pse të dhëna shpeshherë jodirekte – të përpunuara edhe në lidhje me numrin e pjesëtarëve të familjes apo numrin e të punësuarve në familje, mund të nxjerrin supozime të rëndësishme.

Më konkretisht, për pyetjen “*Sa janë afërsisht të ardhurat tuaja familjare?*” janë marrë 92 përgjigje nga gjithsej 94 intervista. Vlera mesatare e të ardhurave është 55,000 Lekë për familje, ndërsa amplituda ndryshon nga 15,000 deri 200,000 Lekë; mesatarja e përbërjes familjare është 4.7 persona dhe mesatarja e të punësuarve për familje është 2.3 persona. Më tej, rezultatet janë klasifikuar në dhjetë kategori, duke filluar nga 15,000-20,000, 21,000-30,000, ... 91,000-100,000 dhe i fundit mbi 110,000 (Fig. 18).




Figura 18. Shpërndarja e të ardhurave familjare në 10 kategori. Sa janë afërsisht të ardhurat tua familjare? (në Lekë). 92 përgjigje, vlera mesatare = 55,000 Lekë për familje; mesatarja e të punësuarve për familje 2.3 persona; mesatarja e përbërjes familjare 4.7 persona.

Nëse rezultatet do t'i gruponim jo në dhjetë klasa, por në katër, do të kishim këtë shpërndarje: 15,000-30,000 lekë (27%), 31,000-50,000 (29%), 51,000-100,000 (36%) dhe mbi 100,000 (8%). Shikojmë se një përqindje shumë e lartë gjendet në klasën e poshtme (27%). Pyetja retorike që mund të shtrohet këtu: si mund të mbijetojë një familje me kaq të ardhura, edhe sikur të nisemi nga numri minimal prej dy personash për familje?! Për të kuptuar më tepër rreth gjendjes social-ekonomike mund të analizojmë pyetjen që ka të bëjë me të ardhurat personale.

Më konkretisht, për pyetjen *"Si i vlerësoni të ardhurat personale?"* janë përgjigjur të gjithë të intervistuarit, dhe shpërndarja në përqindje e përgjigjeve, sipas katër kategorive të përmendura më lart, jepet në figurën 19.




Figura 19: Vlerësimi të ardhurave personale në 4 kategori

Nga rezultatet shihet qartë se thuhet gjysma e punëtorëve të pyetur i konsiderojnë të pamjaftueshme të ardhurat që marrin nga puna e tyre. Kjo e dhënë, edhe pse në vetvete është tepër shqetësuese, e ndërthurur me përgjigje e rezultate të tjera të pyetësorit mund të tregojë më tepër për shtresat më të keqpaguara të punëtorisë. Prandaj në tabelën 1 jepen të dhëna të integruara duke ballafaquar katër kategoritë e të ardhurave personale me të ardhurat familjare, numrin e pjesëtarëve për familje, numrin e të punësuarve për familje, etj. Për të gjykuar më tepër rreth kushteve ekonomike në tabelën 1 është llogaritur edhe raporti midis mesatares të të ardhurave familjare ndaj mesatares të pjesëtarëve të familjes; ky raport (2/3 në tabelë) jep një të dhënë mesatare për të ardhurat për frymë të familjes. Gjithashtu, është llogaritur edhe raporti mesatare të të ardhurave familjare ndaj mesatares të të punësuarve në familje; ky raport (2/4) krijon një ide rreth pagës mesatare.

Ajo që bie në sy nga të dhënat e tabelës është se për dy kategoritë që zënë përqindjen dërrmuese të përgjigjeve (80%), madje edhe të barabarta mes tyre, përkatësisht ato me të ardhura “*të pamjaftueshme*” dhe “*të mjaftueshme*”, ndryshimet për parametrat e tjerë në pamje të parë nuk duken të mëdha. Për shembull, ndryshimi midis dy kategorive në të ardhurat familjare është rreth 10,000 lekë, madje për këtë parametër edhe kapërcimi në kategorinë tjetër (*të mira*) ndryshon po me 10,000 lekë të tjera. Shikojmë se për kategorinë “*të pamjaftueshme*” mesatarja e të ardhurave për frymë është 10,000 lekë, ndërsa për kategorinë “*të mjaftueshme*” 12,000 Lekë, kurse mesatarja e pagës mesatare përkatësisht 25,000 dhe 23,000 lekë për dy kategoritë. Nga dy shifrat e

Tabela 1. Të ardhurat personale në raport me rezultate të tjera të pyetësorit

		Të ardhurat personale në katër kategori			
		Të pamjaftueshme	Të mjaftueshme	Të mira	Shumë të mira
1	Nr. punëtorëve	41	41	10	2
2	Mesatarja të ardhura familjare (në mijë Lekë)	47.4	57.5	68.1	118.0
3	Mesatarja e pjesëtarëve për familje	4.7	4.8	4.2	5.0
4	Mesatarja e të punësuarve për familje	1.9	2.5	2.4	3.5
5	Raporti 2/3: të ardhura për frymë (mijë Lekë)	10.1	12.0	16.2	23.6
6	Raporti 2/4: paga mesatare (mijë Lekë)	24.9	23.0	28.4	33.7
7	Arsimimi universitar	11.0	15.0	4.0	1.0
8	Arsimimi jouniversitar	30.0	26.0	6.0	1.0

fundit vëmë re se paga mesatare është më e lartë në kategorinë e parë, ndërkohë që hipotetiksht duhej të ishte e kundërta. Megjithatë, meqenëse kjo vlerë është mesatare këtu mund të ketë edhe faktorë të tjerë deformues, p.sh. në një familje që punojnë dy vetë amplituda e pagave të të cilëve mund të jetë shumë e madhe, ose mund të kemi raste ku ka vetëm një të punësuar, ndërsa persona të tjerë mund të jenë përfitues të pensionit apo asistencës sociale etj. Megjithatë, përfundimi i parë që mund të nxirret nga këto shifra është se paga që siguron një punëtor nuk është e rëndësishme vetëm në vlerën absolute të saj, por lidhet edhe me përbërjen familjare, dhe se të ardhurat mesatare për frymë – brenda kufirit të gabimit statistikor apo metodik – nuk duhet të zbresin poshtë nivelit 12,000 lekë për t’u konsideruar “të mjaftueshme”. Sakaq, nëse të ardhurat për frymë zbresin poshtë 12,000 lekë për frymë, atëherë ato konsiderohen të pamjaftueshme. Por këto vlera hamendësohen sikur nuk ka kosto strehimi (qira banese), se në rast të kundërt duhej folur me terma të varfërisë ekstreme.

Çështja ndërlikohet më tej nëse ballafaqojmë katër kategoritë e mësipërme me përgjigjet e pyetjes “A ju mjaftojnë të ardhurat për nevojat bazike?”, pyetje së cilës i janë përgjigjur “jo” rreth 60% e të pyeturve. Në figurën 10 ballafaqohen këto përgjigje, dhe menjëherë bie në sy, që në tre kategoritë e para




Figura 20. Ballafaqimi i përgjigjeve për kategoritë e të ardhurave me mjaftueshmërinë për nevojat bazike

kemi përgjigje të ndara në dy grupe për sa i përket mjaftueshmërisë për nevojat bazike (Fig. 20). Më konkretisht, 20% e atyre që në njërin anë i kanë cilësuar të ardhurat personale “*të pamjaftueshme*”, në anën tjetër i konsiderojnë të mjaftueshme për plotësimin e nevojave bazike; edhe në dy kategoritë e tjera “*të mjaftueshme* dhe “*të mira*” përkatësisht 52% dhe 40% e përgjigjeve i konsiderojnë të mjaftueshme në lidhje me nevojat bazike. Këto kontradikta të përgjigjeve mund të shpjegohen me shumë faktorë, të natyrës sociologjike, kulturore, perceptimit etj., si p.sh. relativizmin e “nevojave bazike” nga ana e punëtorëve apo me kërkesa të ndryshme ndaj standardit të jetesë, në varësi përbërjes familjare, kujdesit dhe arsimimit të fëmijëve, pasigurisë së vendit të punës etj.

Më tej, nëse e analizojmë mjaftueshmërinë (apo pamjaftueshmërinë) për nevojat bazike në raport me të ardhurat familjare (Fig. 21), krijojmë një ide më të qartë nga pikëpamja ekonomike. Siç duket edhe në grafik (Fig. 21, sipër) që të ardhurat familjare të mjaftojnë për nevojat bazike duhet që të jenë mbi 15,000 lekë për familje me afërsisht 5 pjesëtarë; nëse i referohemi tabelës 1 më sipër, vëmë re se kjo vlerë i afrohet më tepër kategorisë që është përgjigjur “*të mira*” për të ardhurat personale. Nga ana tjetër për




Figura 21: Ballafaqimi i përgjigjeve për të ardhurat dhe mjaftueshmëria për nevojat bazike

të ardhura për frymë poshtë 9,300 lekë bëhen të pamjaftueshme për të përballuar nevojat bazike (Fig. 21, *poshtë*); të dhënat e fundit korrespondojnë më afër klasës “të pamjaftueshme” për të ardhurat personale të paraqitura në tabelën 1.

Në Republikën e Shqipërisë paga minimale zyrtare është 19,000 lekë, por që siç deduktohet edhe nga këto të dhëna modeste është në një nivel të tillë që nuk mjafton për të përballuar “nevojat bazike” të një familje me tre persona (46,000 lekë), dy të punësuar (38,000 lekë) dhe me banesë në pronësi.

2. Gjendja ekonomike: të dhëna gjinore

Në fokus të studimit tonë ka qenë edhe aspekti gjinor. Më poshtë trajtohen të dhënat e studimit për të parë nëse ka dallime të rëndësishme midis grave dhe burrave. Në figurën 22 krahasohen 4




Figura 22: Ballafaqimi i përgjigjeve për të ardhurat në raport me përkatësinë gjinore

kategoritë sipas përkatësisë gjinore. Më konkretisht 92% e grave, nga gjithsej 49, janë përgjigjur për dy kategoritë e para, 35% dhe 57% përkatësisht për kategoritë “*të pamjaftueshme*” dhe “*të mjaftueshme*”. Ndërsa për burrat kemi 82% të përgjigjeve për dy kategoritë e para, nga gjithsej 45, por këtu 53% e përgjigjeve janë për atë “*të pamjaftueshme*”. Siç duket edhe nga grafikët e figurës 22, por edhe në figurën 23, kemi dy dallime kryesore midis grave dhe burrave. E para që ka të bëjë me raportin e kundërt për dy kategoritë e para, dhe e dyta që për kategorinë “*të mira*” dominojnë burrat. Kështu, mund të shtrohet pyetja se përse ekzistojnë këto dallime? Për raportin e përmbysur të dy kategorive të para disa arsye mund të jenë objektive, si për shembull nivele të ndryshme pagash apo vështirësish për sektorë të ndryshëm punësimi; kujtojmë që shumica e grave të intervistuar dominojnë në numër ndaj burrave në *call center*-a, fasoneri dhe peshkim, ndërsa nga ana tjetër burrat dominojnë në ndërtim dhe miniera. Arsye të tjera mund të jenë edhe të traditës dhe kulturore. Për shembull është fakt i njohur për shoqërinë shqiptare perceptimi që mashkulli duhet të ketë peshën kryesore në sigurimin e të ardhurave të familjes; gjithashtu, një arsye tjetër ka të bëjë edhe me faktin që, sidomos në “shtresat e ulëta” të shoqërisë, burrat janë konsumatorë vetjakë më të mëdhenj në krahasim me gratë, veçanërisht në “argëtim”, konsumin e duhanit dhe alkoolit. Nga ana tjetër, gruaja aq sa është një subjekt më i

nënshtuar e i vuajtur i familjes shqiptare, po aq mund të shfaqë një ndjenjë përgjegjshmërie më të lartë (mirëmenaxhimi) ndaj kushteve ekonomike të familjes. Ky diskutim mund të përforcohet më tej nëse marrim në analizë ndarjen gjinore për përgjigjet e pyetjes “A ju mjaftojnë të ardhurat për nevojat bazike?” (Fig. 24).




Figura 23: Ballafaqimi i përgjigjeve për të ardhurat në raport me përkatesinë gjinore




Figura 24. Ballafaqimi i përgjigjeve për mjaftueshmërinë për nevojat bazike në raport me përkatesinë gjinore

Si mund të shpjegohet dallimi në kategorinë “të mira”? Në fillim duhet theksuar se numri i absolut i përgjigjeve për këtë kategori është vetëm 10 (3 gra dhe 7 burra), një numër tepër i vogël për përpunime matematikore. Megjithatë, nëse supozojmë se kjo ndarje midis grave dhe burrave është e qëndrueshme, atëherë dy mund të jenë arsyet kryesore që i shpjegojnë këto dallime. Së pari që ka të bëjë me sektorin e punësimit (shiko figurën 9), njësoj siç u shpjegua më sipër edhe për dy kategoritë e para. Së dyti, dhe hipotetikisht, dallimi mund vijë edhe prej zënies së mundshme të pozicioneve të larta drejtuese nga burrat në raport me gratë, por që nga

shqyrtimi një për një i kategorisë së të intervistuarve një hipotezë e tillë nuk rezulton e vërtetë, ose e verifikueshme, në këtë rast. Megjithatë, përpos këtyre hipotezave, mund të ketë edhe arsye të tjera që çojnë në këto dallime gjinore.

3. Gjendja ekonomike: sipas sektorëve të punësimit

Në fund të kësaj pjese po shqyrtojmë edhe rezultatet e pyetësorit për nivelin e të ardhurave sipas sektorëve të punësimit. Siç u theksua edhe më lart, mangësia e parë vjen prej numrit jo të përafërt të intervistave midis sektorëve, ku dallohen dy grupe: në njërën anë sektorët *call center*, fasoneri dhe ndërtim kanë numër të përafërt intervistash (nga 23 deri në 29), ndërsa në grupin e dytë sektori minerar dhe peshkimi përkatësisht me 9 dhe 6 intervista. Në figurat 25 dhe 26 jepen rezultatet për dallimet mes sektorëve në tërësi, por edhe duke marrë në konsideratë përkatësinë gjinore.




Figura 25: Ballafaqimi i përgjigjeve për të ardhurat në raport me sektorët e punësimit




Figura 26: Ballafaqimi i përgjigjeve për të ardhurat në raport me sektorët e punësimit, por të ndara sipas gjinisë

Nga grafikët duken qartë disa dallime midis sektorëve. Kështu, për kategorinë “të pamjaftueshme” vihet re se janë në përqindje shumë të lartë në sektorin minerar, pasuar nga sektori i peshkimit dhe ndërtimit, ndërsa dy sektorët e tjerë, *call center* dhe fason, kanë përqindje më të lartë në klasën “të mjaftueshme”. Nga se lindin këto dallime? Kanë të bëjnë direkt me të ardhurat në vlerë absolute të pagës, apo të ardhurat për frymë të familjes (tab. 2)? Apo kanë ndikim edhe faktorë të tjerë si gjinia, shfrytëzimi në punë, statusi familjar etj.?

Tabela 2. Të ardhurat dhe arsimimi në pesë sektorët e punësimit

		Call center	Fasoneri	Ndërtim	Miniera	Përpunim i peshkut
1	Mesatarja të ardhura familjare (në mijë Lekë)	79.0	35.0	48.0	70.0	31
2	Mesatarja e pjesëtarëve për familje	4.5	5.0	4.5	4.7	4.4
3	Mesatarja e të punësuarve për familje	2.7	2.7	1.7	1.3	1.5
4	Raporti: 1/2 (mijë Lekë)	17.6	7.0	10.7	14.9	7.0
5	Raporti: 1/3 (mijë Lekë)	29.3	13.0	28.2	53.8	20.7
6	Arsimimi universitar	27	3	1	0	0
7	Arsimimi jouniversitar	2	23	23	9	6

Për shembull, ia vlen të theksojmë se në *call center*-a 90% e të intervistuarve janë studentë, të cilët në një rëndësi nuk kanë “përgjegjësi familjare”, por që nga ana tjetër kjo cilësi mund të kundërpeshohet nga kërkesat, ambiciet dhe dëshirat për një jetë me standard më të lartë. Ndërsa nga ana tjetër në fasoneri, ku të ardhurat për frymë të familjes janë minimale (7000 lekë, shumë më poshtë se shifrat e diskutuara në fillim të kësaj pjese. Krahazo me të dhënat e tabelës 1!) shumica e të intervistuarve janë gra (80%), 50% vetëm me arsim tetëvjeçar, 40% me arsim të mesëm dhe vetëm 10% me arsim të lartë. Po të shikojmë sektorin minerar, ku të ardhurat për

frymë janë relativisht të larta, të dytat pas *call center*-ave, vështirësia dhe shfrytëzimi në punë mund të jenë arsyet kryesore që i shtojnë minatorët t'i konsiderojnë masivisht të pamjaftueshme të ardhurat e tyre.

Po e mbyllim këtë analizë me përgjigjet e pyetjes “A ju mjaftojnë të ardhurat për nevojat bazike” të ndara sipas sektorëve të punësimit (Fig. 27). Natyrisht që këto të dhëna kanë nevojë të konfirmohen




Figura 27: Ballafaqimi i përgjigjeve për mjaftueshmërinë për nevojat bazike sipas sektorëve

(ose jo) më tej, sidomos në ato sektorë me numër të vogël intervistash (si përpunimi i peshkut), por pas kësaj kambana e alarmit duhet të shqetësojë mbarë shoqërinë, por sidomos qeveritë dhe politikëbërësit.

5.4 Ndërgjegjja klasore e punëtorëve

Ndërgjegjja klasore e punëtorëve shprehet në njohjen e të drejtave bazike punëtore, mënyrën e përfytyrimit të marrëdhënieve pushtetore brenda vendit të punës, imagjinimin e asaj çka duhet të ndryshonte në procesin e punës dhe botëkuptimin më të gjerë politiko-shoqëror të punëtorëve. Për të kuptuar më shumë në fushën e ndërgjegjes klasore kemi përzgjedhur dhe analizuar/interpretuar edhe pyetjen krahasimore midis të punuarit në socializmin despotiko-burokratik dhe në kapitalizmin neoliberal. Më hollësisht jemi përqendruar në këto pyetje:

1. A e dini se ekziston Kodi i Punës?

Qëllimi i pyetjes ka qenë të arrihej të kuptohej niveli i ndërgjegjësimit të punëtorëve për të drejtat dhe detyrimet e tyre siç përcaktohen nga Kodi i Punës në fuqi. Nga 94 punëtorë të intervistuar (Fig. 28), 82% e tyre u shprehën se kanë dijeni mbi ekzistencën e Kodit të Punës. Kjo megjithatë nuk nënkupton se punëtorët që dhanë përgjigje pozitive e njohin hollësisht përmbajtjen e kodit dhe se janë të ndërgjegjshëm për shkallën e respektimit të tij nga punëdhënësi. Ky supozim në radhë të parë rrjedh nga mungesa e sindikatave të

mirëorganizuar në Shqipëri, duke përjashtuar këtu ato që ekzistojnë formalisht, çka e bën thuajse praktikisht të pamundur njohjen në brendësi të Kodit të Punës nga ana e punëtorëve dhe respektimin e tij nga punëdhënësit. Për më tepër, rezultatet e nxjerra nga pyetësi e përforcojnë këtë qasje, si për shembull fakti se 16% e punëtorëve i përgjigjet “nuk e di” pyetjes nëse kontrata e punës është me kohë të plotë apo kohë të pjesshme.




Figura 28: Njohja e Kodit të Punës




Figura 29: Njohja e Kodit të Punës sipas sektorëve

Nga ana tjetër, vënia në dijeni e punëtorëve nga punëdhënësi mbi përmbajtjen e Kodit të Punës, çka është detyrim ligjor, është në një shkallë të ulët pasi vetëm 39% e të intervistuarve është përgjigjur pozitivisht. Edhe në ato raste kur punëtori dëshmon se punëdhënësi e ka vënë në dijeni të përmbajtjes së Kodit të Punës, përgjigjja e mësipërme (ajo e njohurisë së ekzistencës së këtij kodi) ka qenë negative, çka dëshmon frikën e punëtorit për të dëshmuar.

Nga të dhënat vërehet një lidhje e drejtpërdrejtë mes vënies në dijeni nga punëdhënësi dhe njohjes së Kodit të Punës nga punëtorët (Fig. 29). Në mungesë të sindikatave, i vetmi burim informimi mbi këtë të fundit është vetë punëdhënësi. Kështu, vërehet se punëtorët me përqindjen më të ulët të njohjes së Kodit të Punës janë ata të sektorit të ndërtimit në masën 71%. Ky rezultat përkon me nivelin më të ulët të vënies në dijeni nga punëdhënësi, ku në sektorin e ndërtimit kjo realizohet në masën 29%. Në nivel të ngjashëm me sektorin e ndërtimit shfaqen edhe fasoneritë dhe *call center*-at me 38% dhe 31%, çka reflektohet te njohja e kodit në masën 81% dhe 86%. Fabrikat e peshkut, nga ana tjetër, kanë përqindjen më të lartë të njohjes së Kodit të Punës (sipas pohimit të punëtorëve) dhe të vënies në dijeni nga punëdhënësi, përkatësisht në shifrat 100% dhe 83%. Megjithatë këto të dhëna duhen të merren në konsideratë me rezerva, pasi në sektorin e përpunimit të peshkut numri i të intervistuarave është i vogël, vetëm 6 punëtorë.




Figura 30: Njohja e Kodit të Punës sipas gjinive

Sa i përket raportit gjinor (Fig. 30), duket se punëtorët gra që mbizotërojnë në sektorët e industrisë së përpunimit të peshkut, në fasoneri dhe *call-center*-a janë më të informuara lidhur me Kodin e Punës sesa punëtorët burra që mbizotërojnë në sektorin minerar dhe atë të ndërtimit. Duke pasur parasysh grafikët e mësipërm, rezultati në fjalë mund t'i atribuohet ndikimit të përgjigjeve që kanë dhënë punëtorët e sektorit të përpunimit të peshkut në rezultatin e përgjithshëm, rezultat i cili siç u përmend më lartë duhet marrë në konsideratë me rezerva. Nëse do neglizhohej ky sektor atëherë balanca gjinore lidhur me këtë aspekt do të shfaqej e përafërt.

2. A mendoni se po shfrytëzoheni në punë?

Ndjenja e të qenit i shfrytëzuar në vendin e punës përbën një prej kritereve kryesore të matjes së pakënaqësisë sistamore punëtore, si edhe të elementëve të ndërgjegjes politike rezistuese të tyre. Shfrytëzimi është një koncept konotacioni teorik i të cilit është mjaft kompleks dhe lidhet me faktin se në kapitalizëm punëtorët prodhojnë mbivlerë e cila akumulohet prej pronarit. Mirëpo askush nuk pret që teoria e koklavitur të ketë

ndofarë ndikimi në ndërgjegjen punëtore. Ajo që mund të thuhet është se për punëtorët koncepti i shfrytëzimit ka kuptimin e një padrejtësie substanciale që u bëhet në marrëdhëniet e punës.

Pikësëpari duhet thënë se shumica dërrmuese e të intervistuarve, rreth 68%, përgjigjet se ndihet e shfrytëzuar në vendin e punës. Për ta operacionalizuar konceptin e shfrytëzimit, e kemi ndarë në disa indikatorë: të ardhurat familjare, barra e punës dhe presioni i mbikëqyrësit dhe pronarit. Të ardhurat familjare i kemi ndarë në të pamjaftueshme, të mjaftueshme, të mira dhe shumë të mira. Meqenëse të intervistuarit e klasifikuar në dy kategoritë e fundit janë të pakët për të tentuar përgjithësime, do të marrim në shqyrtim përgjigjet e dy kategorive të para. Kësisoj, siç mund të pritet, 63% e atyre që mendojnë se të ardhurat familjare e tyre janë pamjaftueshme ndjejnë se shfrytëzohen në punë. Sakaq, ndjenjën e shfrytëzimit e kanë 73% e atyre të cilët mendojnë se të ardhurat familjare i kanë të pamjaftueshme. Si nënndarje e vlerësimit të ardhurave familjare mund të trajtohet edhe pyetja që u drejtohet punëtorëve se çfarë do të ndryshonin në vendin e punës. Nga punëtorët që deklarojnë se shfrytëzohen në vendin e punës, 67% syresh do të donin të ndryshonin nivelin e pagës. Kësisoj pagat e ulëta dhe, për pasojë, të ardhurat e pamjaftueshme familjare janë faktorët kryesorë të krijimit të ndërgjegjes së shfrytëzimit të punëtorët.

Marrim kriterin ndarës të përgjigjeve të shfrytëzimit sipas barrës së punës. Këtë të fundit e kemi kategorizuar si vijon: e përballueshme, e papërballueshme, e rëndë dhe shumë e lodhshme. Përqindjet e atyre që mendojnë se shfrytëzohen rezultojnë: 54%, 78%, 84% dhe 87%. Ritmi rritës i përgjigjeve tregon qartë se sa më e rëndë të jetë puna e punëtorëve, aq më e fortë është ndjenja e shfrytëzimit të tyre.

I referohemi tani kriterit të presionit që ndjejnë punëtorët nga mbikëqyrësit ose pronari gjatë orarit të punës. 90% e atyre që ndjejnë të tillë presion mendojnë se shfrytëzohen në punë, krahasuar me 64% të atyre që nuk e ndjejnë këtë presion. Në këtë kuptim sa më të ashpra të jenë marrëdhëniet hierarkike klasore brenda vendit të punës, aq më e madhe është ndjenja e shfrytëzimit të punëtorët.

Përveç tri indikatorëve të mësipërm të operacionalizimit të konceptit të shfrytëzimit, mund të përdorim edhe të tjera ndarje interesante për të kuptuar se si luhet ndjenja e shfrytëzimit sipas kategorive moshore, gjinore, arsimore dhe sektorëve të punësimit. Kështu nga punëtorët e rinj (mosha 18-40 vjeç) 74% mendojnë se shfrytëzohen në vendin e punës, kurse nga të vjetrit (40 vjeç e sipër) përqindja e atyre që kanë të njëjtin mendim është 55%. Kjo diferencë mund të shpjegohet edhe prej pritshmërive më të mëdha jetësore që kanë të rinjtë.

Nëse përdorim ndarjen gjinore, 71% e grave të intervistuar shprehen se ndihen të shfrytëzuara në vendin e punës, krahasuar me 64% të burrave. Për të kuptuar se pse një përqindje më e madhe grash se burrash ndihen të shfrytëzuara, do të përpiqemi ta vendosim këtë të fundit në raport me mendimin se barra e punës është e rëndë ose e papërballueshme. Nga gratë që mendojnë se shfrytëzohen në punë, 46% syresh mendojnë po ashtu se puna që bëjnë është e rëndë ose e papërballueshme (mbizotërojnë punëtoret e fasonerisë), kurse për burrat kjo përqindje është 44 (mbizotërojnë punëtorët e ndërtimit). Përqindjet e përafërta nuk na lejojnë të arrijmë në përfundime diferencuese. Mirëpo nëse përdorim kriterin e ditëve të pushimit në javë, do të vëmë re një dallim domethënës gjinor. Kështu, nga gratë që pohojnë se shfrytëzohen në punë 91% e tyre bëjnë një ose nuk bëjnë asnjë ditë pushimi në javë, paçka se ligji u jep të drejtën e dy ditëve. Kurse për burrat kjo përqindje është më e ulët, 69%. Po ta lidhim këtë edhe me traditën shoqërore që e kërkon pasivisht gruan edhe si amvisë, mospasja e dy ditëve pushim mund të perceptohet prej tyre si pamundësi e kryerjes së funksionit të plotë të amvisës gjatë fundjavës.

Nëse i referohemi ndarjes arsimore në 8-vjeçare, të mesme dhe të lartë, do të shohim që ka një theksim të fortë të ndjenjës së shfrytëzimit të kategorisë së arsimit universitar. Kështu, nëse përqindjet e shfrytëzimit në dy kategoritë e para janë përkatësisht 65% dhe 61%, punëtorët e arsimit universitarisht përgjigjen se ndihen të shfrytëzuar në masën 81%. Ky dallim mund të shpjegohet me pritshmëritë më të mëdha që kanë të punësuarit me arsim të lartë, sidomos po të kihen parasysh trajektoret e tyre klasore. Nuk duhet harruar se të arsimuarit universitarë që janë marrë në pyetje nuk i përkasin mikroborgjezisë teknike, siç kanë pritshmëri në të ardhmen, por klasës punëtore, sidomos në *call center*-a.

Kjo e fundit vëhet re edhe në ndarjen e ndjenjës së shfrytëzimit sipas sektorëve. Kështu përqindjen më të lartë të atyre që ndihen të shfrytëzuar e kanë *call center*-at dhe fasoneritë, përkatësisht 76% dhe 77%. Duke ditur se në fasoneri vështirësia e punës është më e madhe dhe pagat më të ulëta sesa në *call center*-a, përqindja shumë e afërt e ndjenjës së shfrytëzimit mund të shpjegohet vetëm me pritshmëritë e mobilitetit klasor të punëtorëve me arsim universitar të *call center*-ave. Këta të fundit, ndryshe nga punëtorët e sektorëve të tjerë të cilët nuk kanë pritshmëri ndryshimi pozicioni klasor, e konsiderojnë punën në *call center* si të përkohshme, si nxjerrëse imediate të ardhurash në kushte papunësie në profesionin e mikroborgjezisë teknike për të cilën janë arsimuar apo po arsimohen. Sakaq në sektorët e tjerë, përveç ndërtimit ku përqindja e atyre që ndihen të shfrytëzuar është 50%, numri i atyre që kanë dhënë përgjigje për këtë pyetje është shumë i vogël për të mundësuar përgjithësim dhe analizë.

Nga ana tjetër, të dhënat cilësore që janë marrë gjatë intervistimit shërbejnë si tregues të tri reagimeve punëtore ndaj shfrytëzimit. Te disa punëtorë vëhet re mllëfi i përzier me frikën, çka del prej përgjigjeve si këto: “Nuk paguhem aq sa më takon.” “Nuk paguhemi mjaftueshëm, por nuk flasim dot.” Te të tjerë vëhet re dorëzimi ndaj shfrytëzimit: “Kështu ndodh në Shqipëri, shfrytëzohesh.” Ama përmendja e kushteve të jetesës nxjerr në pah një potencial të vogël rezistence: “...se kështu janë gjërat, sa për t’u ushqyer.” Në fund fare nxjerr krye punëtori që e ka brendësuar dhunën klasore brenda vendit të punës dhe ideologjinë sunduese: “Përderisa ke ardhur të punosh, do të thotë që ke ardhur të shfrytëzohesh.”

3. Çfarë do të doje të ndryshoje në punën që bën?

Pyetja që u kërkon punëtorëve të shprehin për atë që do të ndryshonin në vendin e punës ka marrë përgjigje më uniforme se çdo pyetje tjetër. 64% syresh janë përgjigjur se do të donin të ndryshonin pagën. Përgjigjet e tjera si punën, kushtet e punës, asgjë etj., janë në minorancë të skajshme. Arsyeja kryesore se pse dëshirohet ndryshimi i pagës ka të bëjë edhe me vlerësimin e punëtorëve për të ardhurat e tyre. Nga ata që janë përgjigjur “paga”, gjysma mendojnë se të ardhurat e tyre familjare janë të pamjaftueshme për të përballuar jetesën. Madje edhe ndjenja e shfrytëzimit lidhet me dëshirën për të ndryshuar pagën. 72% e punëtorëve që duan të ndryshojnë pagën mendojnë gjithashtu se shfrytëzohen në punë.

Nëse marrim në shqyrtim se si i janë përgjigjur punëtorët e sektorëve të ndryshëm kësaj pyetjeje, mund të bëjmë dallime me interes. Po marrim në shqyrtim për të bërë përgjithësimet sektorët ku ka pasur një numër përgjigjesh të mjaftueshme: *call center*, ndërtim dhe fasoneri. Përgjigjedhënësit që do të donin të ndryshonin pagën në ndërtim zënë 50%, në *call center* 55%, kurse në fasoneri 81%. Nga kjo e dhënë mund të dalim në përfundimin se niveli i pagave në industrinë fasonere është nga më të ulët, së paku në mendimin e punëtorëve të këtij sektori.

Nga ana tjetër kategoritë gjinore dhe moshore nuk dallojnë fort nga njëra-tjetra dhe as nga përqindja e numrit të përgjithshëm të punëtorëve që mendojnë se paga do të ishte gjëja e parë që do të donin të ndryshonin në punën e tyre.

4. A mendoni se punëtorët mund ta marrin vetë drejtimin e vendit të punës pa pronarin?

Një nga pyetjet që prek drejtpërdrejt çështjen e ndërgjegjes punëtore është ajo e përfytyrimit të drejtimit të vendit të punës nga punëtorët. Pyetja qëllimisht nuk e ka specifikuar nëse bëhet fjalë për bashkëpronësi punëtore apo për administrim punëtor duke ruajtur pronësinë e pronarit mbi mjetet e prodhimit për të mos humbur në detaje fare pak të rëndësishme në kushtet e hegjemonisë kulturore të kapitalizmit neoliberal. Siç mund të pritej po të kemi parasysh këtë të fundit dhe mungesën në historinë moderne të Shqipërisë të përvojave të drejtimit të ndërmarrjeve nga punëtorët (Shqipëria e socializmit despotiko-burokratik nuk eksperimentoi me modelin jugosllav të vetadministrimit punëtor duke i lënë ndërmarrjet në duart e burokracisë teknike dhe organizatës së partisë pararojë), shumica e të intervistuarve, rreth 64% e tyre, nuk mendojnë se punëtorët mund të marrin drejtimin e vendit të punës. Mirëpo vend për mendim kritik lë fakti se, propëseprapë, rreth 32% e tyre janë të mendimit se mund ta drejtojnë procesin e punës.

Po si shpërndahen përgjigjet sipas prerjeve të ndryshme të punëtorisë. Ajo që bie në sy është përqindja relativisht e lartë e atyre që mendojnë për vetadministrim punëtor në sektorin e ndërtimit, thuajse gjysma. E vetmja e dhënë që mund të përdorim për të shpjeguar këtë zhdrejtpeshim ka të bëjë me faktin se disa prej të intervistuarve në sektorin e ndërtimit kishin përvojë të gjerë pune në Greqi, vend në të cilin ndërgjegjja punëtore shquhet për radikalizëm dhe ka përvojë të vetadministrimit punëtor.

Nëse përdorim prerjen gjinore do të vëmë re një tjetër zhdrejtpeshim. Vetëm rreth 22% e grave të intervistuarja janë të mendimit se mund të marrin në dorë drejtimin e vendit të punës, sakaq përqindja e burrave që pohojnë të njëjtën gjë është pothuajse e dyfishtë, rreth 42%. Arsyeja e mundshme e ndërgjegjes më radikale punëtore në radhët e burrave mund të gjendet në përvojën familjare dhe ideologjinë kulturore me ndikim patriarkalist, të cilat ndikojnë vetëpërfytyrimin e grave si gjini e nënshtruar ndaj autoritetit jo vetëm në sferën private (shtëpi), por edhe në atë publike (vend pune).

Interesant është edhe dallimi që del në pah po të përdorim kriterin ndarës moshor. Ndarja moshore ka qenë dihotomike, ku në brezin 18 deri në 40 vjeç bëjnë pjesë punëtorët e rinj, kurse nga 40 e tutje të vjetrit. Konkretisht, rreth 38% e të rinjve përgjigjen se punëtorët mund ta marrin në drejtim vendin e punës, kurse te të vjetrit përgjigje pozitive kanë dhënë 21%. Nëse i lidhim këto përgjigje me ato të të dyja grupeve moshore me ndjenjën e shfrytëzimit në vendin e punës, mund të dalim në përfundimin se faktor i mendimit se punëtorët mund ta marrin në dorë vendin e punës është edhe ndjenja më e madhe e shfrytëzimit që kanë të rinjtë, e cila nuk tregon shfrytëzimin objektiv të tyre, por faktin se ata si subjekte janë më të ndjeshëm ndaj padrejtësive në vendin e punës apo janë më të gatshëm të shprehen të pakënaqur. Argument shpjegues potencial mund të jetë edhe botëkuptimi më barazimtar i të rinjve, fakti që janë më pak riprodhues të marrëdhënieve hierarkike në familje etj.

5. Keni punuar para vitit 1990? - Nëse po, a ishin më mirë apo më keq?

Kjo pyetje ka pasur për synim krahasimin e përvojës së punës në dy sisteme të kundërta shoqërore: socializmin despotiko-burokratik dhe kapitalizmin neoliberal. Numri i të intervistuarve që janë shprehur për këtë çështje ka qenë mjaft i kufizuar për shkak të kufizimeve moshore. Nëse marrim si moshë pune minimale 18-vjeçarën e

kohës (arsimi 12-vjeçar ka qenë i detyrueshëm gjatë socializmit), atëherë i bie që të intervistuarit gjatë vitit 2015 të kenë qenë së paku mbi moshën 43-vjeçare. Kësisoj përgjigje për pyetjen e të punuarit dhe krahasimin midis dy përvojave e ka dhënë një numër prej 23 të intervistuarish.

Nga të 23-të, një shumicë prej 14 të intervistuarish janë përgjigjur se përvoja e punës gjatë socializmit ka qenë më e mirë¹⁵, çka të lë mundësi të vësh në dyshim ideologjinë hegjemonike të këtyre dekadave për dënimin e gjithanshëm të marrëdhënieve shoqërore socialiste (jo thjesht aspektit diktatorial të sferës politike) dhe vendosjen në antipod të marrëdhënieve shoqërore kapitaliste. Së paku për shumicën e të intervistuarve nga klasa punëtore në të dyja kohërat, përvoja socialiste rezultoi më e mirë.

Për të kuptuar arsyet e këtij dallimi, duhet ta thellojmë nivelin e analizës së paku sektorialisht, pasi të dhënat gjinore janë të pamjaftueshme për të nxjerrë çfarëdo përfundimi të përkohshëm. (Nga 51 gratë e punësuar, vetëm 7 syresh janë përgjigjur se kanë punuar edhe gjatë socializmit, ndërsa përgjigjet e tyre janë të ekuilibruara midis “më mirë”, “më keq” apo “njëlloj”.) Po ashtu, nga analiza do të përjashtohen punonjësit e *call center*-ave për shkak të caktimit të moshës. Fuqia punëtore e *call center*-ave është jo vetëm më e arsimuara, por edhe më e reja, pa përvojë punësimi gjatë socializmit. Nga sektorët e tjerë mund të rendisim si me përvojë më të mirë pune në socializëm fasonerinë, minierat, ku të gjitha përgjigjet kanë qenë pozitive. Paskëta vijojmë me sektorin e ndërtimit ku mbizotëron përvoja më e mirë për të shkuarën, kurse në sektorin e peshkimit të gjitha përgjigjet e vendosin përvojën gjatë socializmit si më të keqe krahasuar me aktualen.

Çfarë shpjegimi mund t’u japim këtyre ndryshimeve sektoriale? Është e vështirë të rendisë argumente për sektorin e fasonerisë dhe të peshkimit për shkak të numrit shumë të vogël të të përgjigjedhënësve (përkatësisht 2 dhe 3). Mirëpo të dhënat nga sektori minerar dhe ndërtimi na i krijojnë premisat minimale për interpretim. Kësisoj mund të veçojmë faktin se minatorët kanë pasur jo vetëm pagë dhe pensione të lakmueshme për kohën (socializmi) – çka shpjegohet jo vetëm me punën e kualifikuar, por edhe me rëndësinë strategjike të sektorit minerar gjatë socializmit – por edhe status shoqëror të ngritur, si pararojë profesionale e klasës punëtore. Po ashtu rënia drastike e produktivitetit të sektorit minerar dhe e tatëpjeta e shpejtë e kushteve të punës dhe të jetesës së minatorëve gjatë kapitalizmit neoliberal, na shtojnë të kuptojmë se për minatorët (përkatësisht ata të Bulqizës) ndërrimi sistemor rezultoi i përkeqësuar nga pikëpamja e kushteve të punës. Sakaq, shpërhapja më horizontale e përgjigjeve në sektorin e ndërtimit (pavarësisht se edhe këtu mbizotëron ideja se në socializëm puna ka qenë më e mirë), mund të vijë si rezultat i faktit se, ndryshe nga minatorët, origjina profesionale e punëtorëve të ndërtimit është më e larmishme. Nëse gjasat që një minator mbi 43-vjeçar të ketë qenë minator edhe në socializëm janë të mëdha, mundësia e të punësuarve në sektorin e ndërtimit për të pasur vijueshmëri profesionale është më e ulët për shkak të zhvillimit shumë të madh të sektorit të ndërtimeve në kapitalizmin neoliberal dhe nevojës për fuqi punëtore edhe pak të kualifikuar ose në kualifikim e sipër gjatë procesit të punës.

Si mund ta interpretojmë në tërësi mbizotërimin e përgjigjeve se të punuarit gjatë socializmit ka qenë më i mirë për shumicën e dhënësve të përgjigjeve? Pikësepari, duhet të dallojmë se në një mënyrë prodhimi që ka për qëllim të vetëm fitimin, sidomos në kushte pasigurie dhe konkurrence, shfrytëzimi sa më intensiv i punëtorëve dhe reduktimi i pagave reale përbën një nga mekanizmat kryesorë të mbijetesës ekonomike. Sakaq, një sistem socialist, edhe nëse produktiviteti i ulët nuk ia lejon rritjen e pagave reale, ka shumë më pak shtysa për ta

¹⁵ Përgjigjja e njërit prej punëtorëve të ndërtimit mund të shërbejë si tregues cilësor i raportit të punëtorëve me formacionin shoqëror të kapitalizmit neoliberal: “Për shtresën punëtore s’ka shpresë dhe nuk investon njeri.”

intensifikuar shfrytëzimin e fuqisë punëtore pasi operon në kushte jokonkurrueshmërie. Nga ana tjetër, planifikimi i centralizuar ekonomik rezulton, sidomos në kushtet kur nuk kërkohet industrializim i shpejtë, të ekuilibrojë domosdoshmërinë e rritjes së produktivitetit me fatet e punëtorisë, e cila, nuk duhet harruar, përbënte shtyllën ideologjike të socializmit. Po t'i shtojmë këtu edhe faktin që në vitet e fundit përpara 1990, socializmi kishte hyrë në stanjacion produktiv, madje pse jo edhe në rënie në disa sektorë, dhe ekzistonin kushtet e mbipunësimit, intensiteti i punës në mjaft sektorë ka qenë i ulët. Kësisoj, ndjenja e shfrytëzimit apo e kushteve të këqija të punësimit atyre viteve mund të ketë qenë më e vogël krahasuar jo vetëm me dekadat e tjera të socializmit, por edhe me ç'pason në kapitalizmin neoliberal.

VI. PËRFUNDIME PARAPRAKE

Siç e kemi përmendur disa herë, numri i kufizuar i intervistave na e ka bërë të pamundur daljen në përfundime të plota dhe të sigurta për gjendjen e klasës punëtore në Shqipëri. Mirëpo edhe në këtë fazë të përpunimit të të dhënave dhe interpretimit të dëshmimeve punëtore mund të tentojmë disa përfundime paraprake.

Për sa u përket kushteve të punës dhe respektimit të të drejtave ligjore, analiza sasiore, dëshmitë cilësore dhe sitja kritike e përgjigjeve të marra na sjellin në përfundimin se në vendin e punës punëtorët shfrytëzohen me intensitet të lartë deri në rrezik jete apo dëmtimi shëndetësor, u cenohen të drejtat bazike si ato të pagimit të mbipunës apo respektimit të ditëve të pushimit javor etj.

Arsyeja kryesore e këtij shfrytëzimi gjendet në marrëdhëniet pushtetore tërësisht hierarkike brenda vendit të punës. Pronari ka pushtet thuajse absolut mbi punëtorët dhe, në rrethanat e mosinspektimit të imët nga autoritetet shtetërore, ai bëhet zotërues konkret i fatit të punëtorëve brenda orarit të punës. Ky pushtet (despotizmi i fabrikës do ta quanin teoricienë kritikë të marrëdhënieve kapitaliste të punës) buron edhe nga niveli i lartë i papunësisë, çka ndikon që organizimi dhe rezistenca aktive punëtore të jenë inekzistente ose, në rastet më të mira, rudimentare.

Si të tejshfrytëzuar dhe të nënshtruar në marrëdhëniet e punës, punëtorët fitojnë nga puna e tyre të ardhura të pamjaftueshme për të bërë një jetë shoqërisht dinjitoze. Pavarësisht dallimeve sektoriale, të zënit e pozicionit të punëtorit në shkallaren shoqërore nënkupton varfëri dhe mbyllje perspektive mëkëmbjeje shoqërore.

Pa të drejta, të shfrytëzuar, të frikësuar deri në nënshtrim dhe të varfër, punëtorët e intervistuar dëftojnë në masë ndërgjegje klasore të ulët. Kjo duket si në mosnjohjen e akteve ligjore bazike, të drejtave kyçe apo koncepteve organizative, ashtu edhe në mospërfytyrimin të vetes si klasë brenda shoqërisë. Sidoqoftë, nga kushtet e mësipërme burojnë në raste të veçanta edhe ide subversive si ato të barazisë apo, në raste më të rralla, ato të rritjes së zërit punëtor në drejtimin e ndërmarrjeve. Përmbysja e fundit tregon se hegjemonia ideologjike klasore nuk arrihet asnjëherë plotësisht, por mbart brenda vetes oazë përfytyrimesh rezistente të cilat orvatet t'i integrojnë në forma më të larta të ligjërimit politik, si p.sh. mënyrën se si ngulmimi punëtor tek ideja e barazisë shoqërore sublimohet në idetë e një barazie politike elektoraliste dhe barazie juridiko-formale.

Sidoqoftë na duhet ta ritheksojmë se ky punim është vetëm pjesa e parë e studimit të gjendjes së klasës punëtore në Shqipëri. Botimit të dytë do t'i paraprijë intervistimi i rreth 200 punëtorëve të tjerë. Të dhënat dhe dëshmitë që presim të mblidhen gjatë vitit 2016 do të na shërbejnë për të bërë përgjithësime dhe korrelacione më të sigurta, si edhe për të depërtuar më thellë në indin klasor të punëtorisë. Sidoqoftë, ndryshe nga intervistimet e subjekteve të tjera shoqërore, vështirësitë e procesit të intervistimit nuk duhen parë vetëm si

mangësi studimore, por, tërthorazi, edhe si dëshmi të gjendjes mjerane të klasës punëtore në Shqipëri. Nëse mosrealizimi i numrit të parashikuar të intervistave mbi, bie fjala, shijet muzikore të rinisë gjimnaziste përbën mangësi studimore, mosrealizimi i plotë i intervistave punëtore mund të vijë prej frikës apo tejlodhjes së punëtorit që i drejtohem për intervistë, çka tërthorazi na dëshmon për kushtet e punës dhe të jetesës së tij.



Ole Elfenkämper, Bulqizë 2012